

BAHRI BECI

# VALLE FJALËSH DHE FJALISH

GJUHA SHQIPE 3  
për klasën e tretë të shkollës  
fillore nëntëvjeçare  
LIBRI I MËSUESIT

*Libri shkolla*

*Gjuha  
e bukur flasin*

*Si bukur shkruajmë*



Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore  
PODGORICË, 2007

Dr. BAHRI BECI

# VALLE FJALËSH DHE FJALISH ГЈУНА ШҚІРЕ 3

për klasën e tretë të shkollës fillore nëntëvjeçare  
LIBRI I MËSUESIT

## ИГРА РИЈЕЧИ И РЕЧЕНИЦА АЛБАНСКИ ЈЕЗИК 3

за трећи разред деветогодишње основне школе  
ПРИРУЧНИК

*Botuesi:* Enti i Teksteve dhe i Mjeteve Mësimore; Podgoricë

*Kryeredaktore dhe  
redaktore përgjegjëse:* Natasha Zhivković

*Redaktor:* Zarija Brajović

*Recensentë:* Prof. dr. Mark Camaj  
Prof. dr. Pjetër Gjuravçaj  
Nazire Kurmemović, mësuese e ciklit të ulët  
Prof. dr. Fatmir Vadahi, pedagog  
Prof. dr. Vehbi Hoti, psikolog

*Ilustrimi:* Simon Vučković

*Disenjoja  
dhe faqosja:* Sasha Protiq

*Korrektor:* Dimitrov Popović

*Redaktor teknik:* Rajko Radulović

*Për botuesin:* Nebojsa Dragović

*Shtypur në* Studio "Mouse", Podgoricë

*Tirazhi:* 50

ISBN: 978-86-303-1218-2

Këshilli i Arsimit të Përgjithshëm, me vendimin nr. 04-3-252 të datës 08.10.2007 e ka miratuar këtë tekst mësimor për përdorim në shkollat fillore nëntëvjeçare.

## PASQYRA E LËNDËS

Struktura dhe përmbajtja e Librit të nxënësit dhe e Fletores së punës . . . . .	4
Ecuria metodike për realizimin e synimeve . . . . .	9

### PJESA E PARË

Ne flasim shqip, po Marina... . . . .	10
Në shtëpi dhe në shkollë . . . . .	11
Bisedojmë me njëri-tjetrin . . . . .	13
Alo, mirëdita... . . . .	14
Dua të telefonoj... . . . .	15
Si të ftojme? . . . . .	17
Afërdita ka ditëlindjen . . . . .	19
Tregim sipas figurave . . . . .	20
Si të urojmë . . . . .	22
Ata morën fletëlavdërimi . . . . .	24
Tregim sipas figurave . . . . .	25
Flasim për programet televizive . . . . .	26
Tregim sipas figurave . . . . .	27

### PJESA E DYTË

Teksti dhe fjalia . . . . .	30
Guri i Skënderbeut . . . . .	32
Fjalë që tregojnë njerëz, kafshë dhe sende . . . . .	33
Tregim sipas figurave . . . . .	35
Si shkruhen emrat e përveçëm . . . . .	36
Në kalanë e Ulqinit . . . . .	37
Fjalë që tregojnë cilësi . . . . .	38
Si të përshkruajmë . . . . .	40
Fjalë që tregojnë veprime . . . . .	42
Kryefjala dhe kallëzuesi . . . . .	44
Dy pikat dhe presja . . . . .	46
Tregim sipas figurave . . . . .	47

### PJESA E TRETË

Toka rrotullohet . . . . .	50
Emrat kanë gjini dhe numër . . . . .	51
Mbiemrat kanë gjininë dhe numrin e emrave . . . . .	52
Dhëmbët tanë . . . . .	53
Fjalë që zëvendësojnë emrat . . . . .	54
Tek ne rriten shumë zarzavate . . . . .	55
Dje, sot, nesër . . . . .	56
Tek ne ka shumë fruta . . . . .	57
Pjesët plotësuese të fjalisë . . . . .	58
Tek ne ka shumë lloje peshqish . . . . .	59
Shqiponja . . . . .	60
Viti i Ri . . . . .	61
Dikur ishte fushë . . . . .	62
Veglat tona popullore . . . . .	63

# STRUKTURA DHE PËRMBAJTJA E LIBRIT TË NXËNËSIT DHE E FLETORES SË PUNËS

Libri *Valle fjalësh dhe fjalish 3* është vazhdim i drejtpërdrejtë i teksteve *Valle tingujsh dhe shkronjash 1 dhe 2* në synimet e tij për ta përvetësuar mësimin e gjuhës amtare përmes të dëgjuarit, të folurit, të lexuarit dhe të shkruarit. Ndryshon prej tyre në strukturë, për shkak të ndryshimit të vetë përmbajtjes së mësimin të gjuhës amtare në klasën e tretë, që ka në thelbin e kërkesave të saj, jo mësimin e shkronjave dhe të lexim-shkrimit, po rritjen graduale të aftësive për të folur, për të lexuar dhe për të shkruar. Njohja e veçorive të sistemit të gjuhës letrare shqipe, ndonëse në klasë të tretë zë një vend më të dukshëm se në dy klasat para saj, konceptohet si praktikë gjuhësore. Kjo diktohet nga veçoritë e zhvillimit mendor e psikik të fëmijëve të kësaj moshe. Pra, në këtë nivel shkollimi, mësimi i gjuhës amtare është praktikë gjuhësore.

Libri ka tri pjesë themelore që përcaktohen nga problematika kryesore e trajtuar në secilën prej tyre.

## Pjesa e parë

Tematika e teksteve të kësaj pjesë të parë lidhet kryesisht me veprimtaritë dhe mjedisin shoqëror ku jetojnë fëmijët (*Ne flasim shqip, po Marina ... , Në shtëpi dhe në shkollë, Bisedojmë me njëri-tjetrin, Alo, mirëdita..., Dua të telefonoj ..., Si të ftojme? Afërdita ka ditëlindjen, Si të urojmë?, Ata morën fletëlavdërimi, Flasim për programet televizive dhe Tregim sipas figurave*). Në këtë pjesë të parë ata njihen me tipa të ndryshëm tekstesh joletrare dhe ushtrohen të hartojnë vetë tekste të tilla, si urime, ftesa, falënderime etj.

Dy tekstet e para i kushtohen gjuhës amtare dhe zyrtare që fliten në Mal të Zi dhe dallimit gjuhë letrare e gjuhë joletrare (*Ne flasim shqip, po Marina ... , Në shtëpi dhe në shkollë*).

Synimi i parë i këtyre mësimëve është që nxënësit të kuptojnë realitetin gjuhësor në Mal të Zi dhe vendin e shqipes në këto hapësira. Mësuesi mundet ta zhvillojë më gjerë këtë temë, duke u përqendruar edhe në disa veçori kulturore, po kjo në varësi të interesimit të nxënësve dhe të kohës që ka në dispozicion. Është e rëndësishme, që në çdo rast të marrim parasysh veçoritë e moshës së fëmijëve.

Kryesore është të kemi parasysh që mësuesi në gjithë procesin e përvetësimit të njohurive drejton, ndihmon dhe këshillon nxënësit, por nuk jep zgjidhje të gatshme; janë nxënësit ata që nën drejtimin e mësuesit i zbulojnë njohuritë.

Synimi i dytë i këtyre mësimëve është të dallojnë konceptet *gjuhë letrare* dhe *joletrare* si dy forma të shfaqjes së gjuhës që ekzistojnë paralelisht në të gjitha gjuhët. Nxënësit duhet të dinë, se nuk flasim njësoj në shtëpi dhe në shkollë. Në këtë rast, është mirë të sqarohet se ekziston gjuha standarde; gjuha letrare, e cila ka rregullat e veta dhe që me të shkruhen librat.

Siç dihet Gjuha letrare; gjuha standarde, është gjuhë e përgjithshme e normuar, e cila shërben për t'u marrë vesh dhe për të shkruar tekste letrare dhe joletrare. Ajo është rezultat i marrëveshjes mes njerëzve dhe zhvillimit të gjuhës. Gjuha letrare ka normën e vet (rregullat e veta) drejtshqiptimore, drejtshkrimore, gramatikore dhe leksikore.

Këto veçori të gjuhës letrare, sigurisht, nuk janë objekt i trajtimit në këtë cikël të shkollës nëntëvjeçare, por mësuesi duhet t'i ketë parasysh në procesin e punës së tij konkrete me fëmijët edhe të kësaj moshe. Në këtë kuadër, në tekst flitet edhe për fjalët e huaja. Synimi është të sensibilizohen fëmijët, aq sa është e mundur, se në gjuhën shqipe përdoren mjaft fjalë të huaja, të panevojshme, të cilat e dëmtojnë gjuhën shqipe.

Problematika që lidhet me fjalët e huaja në gjuhën shqipe është e gjerë, por këtu jepen vetëm disa nocione fillestare, të cilat më vonë do të zgjerohen e thellohen.

Themelore është që nxënësit të fillojnë të ndjejnë nevojën për të folur jo si në shtëpi, po siç flitet pak a shumë në radio ose televizion ose siç shkruhet në librat që ata lexojnë. Është një punë që zë fill këtu, por që do të vazhdojë të jetë synim themelor gjatë gjithë viteve të jetës shkollore. Këtu ka rëndësi themelore puna dhe shembulli personal i mësues-it/ses. Ato duhet të jenë modeli i përdorimit me korrektësi të gjuhës letrare dhe të përdorin të gjitha mjetet dhe metodat që ndihmojnë në këtë drejtim..

Fëmijët nuk duhet t'i kritikojmë as t'u flasim me ashpërsi, kur në shkollë flasin si në shtëpi. Ata përmes mësimit *Në shtëpi dhe në shkollë* në faqen \_\_\_\_ të Librit të nxënësit, do të kuptojnë, se ndryshe flasim në shtëpi me nënën dhe ndryshe në shkollë me mësues-in/sen.

Në Librin e nxënësit, fq. \_\_\_\_ në mësimin *Bisedojmë me njëri-tjetrin*, është dhënë një *bisedë*, ku njëri nga bashkëbiseduesit e ndërpret shokun, kur ai flet me shitësen e librarisë. Qëllimi është që fëmijët të kuptojnë, se nuk duhet ta ndërpresin shokun, kur është duke folur me një tjetër. Përmes këtij mësimi, por edhe të mësimëve të tjera, duhet të kuptojnë çdo të thotë bashkëbisedim korrekt. Për këtë qëllim, mund të shfrytëzohen lojërat me role, ku t'u jepet fëmijëve mundësia të dallojnë bisedat korrekte dhe jo korrekte. .

Në mësimet *Alo, mirëdita* dhe *Dua të telefonoj* synohet të aftësohen nxënësit jo vetëm të flasin me korrektësi në telefon, po edhe të përdorin numërorin telefonik, përfshirë edhe numërorin telefonik që mund të bëjnë ata vetë.

Në mësimet *Si të ftojme?* Dhe *Afërdita ka ditëlindjen*, fëmijët do të njihen me lloje të ndryshme ftesash, me ato që dërgohen për një ngjarje personale (ditëlindje) dhe me ato që dërgohen për një ngjarje publike (ekspozita). Kështu kanë rast të dallojnë ngjashmëritë dhe ndryshimet mes mënyrës, sesi ftohen miqtë për një ngjarje personale ose publike.

Do të mësojnë, se ftesa duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin e atij që e dërgon, emrin dhe mbiemrin e atij të cilit i dërgohet, shkakun e organizimit të festës, datën e organizimit të festës, orën e fillimit të veprimtarisë, adresën ku do të zhvillohet, numrin e telefonit të atij që e organizon festën. Do të mësojnë, se ftesën mund ta bëjnë vetë, ta porositin ose ta blejnë. Po kështu, duhet të mësojnë se, kur marrin një ftesë, duhet ta njoftojnë dërguesin që e kanë marrë ftesën, se do të marrin apo nuk do të marrin pjesë dhe ta falënderojnë.

Në mësimet *Si të urojmë* dhe *Ata morën fletëlavdërimi*, fëmijët do të mësojnë që urimet, lavdërimet, mirënjohjet mund të bëhen me gojë ose me shkrim, që ato mund të jenë private ose publike. Për këtë qëllim, mund të organizohen në klasë edhe veprimtari të veçanta për nxënës të mirë, për nxënës të sjellshëm, po edhe për mësues duke përgatitur për këtë qëllim edhe ftesat përkatëse.

Në Fletoren e punës ka ushtrime për shumicën e mësimëve që kanë të njëjtin titull si në Librin e nxënësit. Përmes tyre ato do të ushtrohen të flasin e të shkruajnë në gjuhën letrare, të flasin në telefon me një gjuhë të kulturuar, të shkruajnë ftesa, urime e falënderime. Po kështu, për mes mësimesh të veçanta dhe tregimeve sipas figurave do të nxiten fëmijët të flasin e të shkruajnë për probleme të jetës së përditshme si programet televizive, reklamat, por edhe më gjerë.

## Pjesa e dytë

Tematika e kësaj pjese të dytë lidhet me përshkrimin e njerëzve, të kafshëve si edhe me tregimin e ngjarjeve nga jeta dhe sipas figurave. Në këtë pjesë të dytë, nxënësit do të njihen me tipa të ndryshme tekstesh joletrare dhe po edhe ndonjë letrare dhe do të ushtrohen të hartojnë vetë tekste të tilla (*Edlira ka blerë kompjuter*, *Edlira është e gëzuar*, *Guri i Skënderbeut*, *Në Kalanë e Ulqinit*, *Qytetet tona*, *Vendlindja ime*, *Të drejtat e lapsave*, *Shoku im*, *Maçoku i Emit*, *Flutura*, *Shoku im*, *Rruga ime për në shkollë*, *Rudina është e trishtuar*, *Miki Maus*, *Dy shokët*,

*Shokët e klasës, Dhelpra dhe lejleku*). Përmes pyetjeve që shoqërojnë tekstet nxënësit ushtrohen të lexojnë tekste, t'i kuptojnë ato, të dallojnë gjërat e rëndësishme nga ato më pak të rëndësishme, gjërat e njohura nga ata më pak të njohura etj.

Mësimet e tjera të kësaj pjese u kushtohen njohurive për veçoritë e sistemit gjuhësor. Përmbajtja e njohurive për sistemin gjuhësor është vazhdim e thellim i njohurive të fituara në klasë të parë e të dytë (*Teksti dhe fjalia, Fjalë që tregojnë njerëz, kafshë dhe sende, Si shkruhen emrat e përveçëm, Fjalë që tregojnë cilësi, Fjalë që tregojnë veprime, Kryefjala dhe kallëzuesi, Dy pikat dhe presja*), po edhe këto trajtohen në masën që lejon mosha e fëmijëve të klasës së tretë dhe në pajtim me veçoritë e zhvillimit mendor e psikologjik tyre. Në renditjen e njohurive nuk jemi nisur nga ndarja drejtshkrim, morfologji, sintaksë, por nga veçoritë funksionale të kategorive gramatikore. Pra, nxënësit dallojnë fillimisht, për shembull, fjalët që tregojnë cilësi për të arritur pastaj tek nocioni i kategorisë gramatikore të mbiemrit e kështu me radhë për emrin, foljen etj. Në parashtrimin e njohurive gjuhësore përdoret metoda induktive. Përmes pyetjeve që shoqërojnë tekstet, nxënësit nxiten t'i zbulojnë vetë rregullat drejtshkrimore ose nocionet gramatikore, duke kërkuar prej tyre që ta dallojnë, njohin, sqarojnë dhe në fund ta emërojnë kategorinë gramatikore të mësuar.

Në këtë moshë, por as më vonë, nuk duhet të kërkojmë që ata t'i riprodhojnë në mënyrë mekanike rregullat gramatikore, po që të aftësohen për t'i dalluar kategoritë gramatikore dhe për të shpjeguar se përse shërbejnë.

Pas shqyrtimit të fjalëve që tregojnë cilësi vjen mësimi *Si të përshkruajmë?* Ku jepet përshkrimi i një personi (*Shoku im*), i një kafshe (*Maçoku i Emit*), i një insekti (*Flutura*), i rrugës nga shtëpia deri tek shkolla (*Rruga ime për në shkollë*).

Vazhdohet pastaj me tekste tregimtare (*Miki Maus, Dy shokët*) duke krijuar mundësinë, që fëmijët të dallojnë tekstet përshkruese nga tekstet treguese. Një variant i teksteve të folura ose të shkruara, treguese janë përjetimet e fëmijëve. Është rasti që fëmijët të dallojnë tregimet nga përjetimet. Shumica e metodistëve i dallojnë përjetimet nga tregimet. Për ata tregimet janë ngjarjet që fëmijët i përshkruajnë në bazë të konstatimeve që nuk lidhen me jetën e tyre. Përkundrazi, përjetimet lidhen drejtpërdrejt me jetën e fëmijës, sepse paraqesin gëzimet, dëshirat, qëndrimet dhe vlerësimet e tyre. Tregimet, në dallim nga përshkrimet, kanë tri pjesë themelore: a) hyrjen ose fillimin, ku paraqiten personazhet që marrin pjesë, vendi dhe koha; b) vazhdimin ose zhvillimin, ku paraqiten ngjarjet në rrjedhën logjike të tyre; c) përfundimin ose zgjidhjen e problemeve dhe të vështirësive.

Duhet pasur parasysh, se fëmijët nuk e kanë të lehtë të shkruajnë për një tematikë të caktuar, sidomos kur nuk e kanë përjetuar ato. Prandaj u duhen ofruar jo një, por disa tema që ata të kenë mundësi të zgjedhin. Gjithashtu, duhet t'i sqarojmë fëmijët, se nuk është e domosdoshme që të ndodhin gjëra të mëdha që pastaj të shkruhet për to. Gjithsesi, është mirë që ata të shkruajnë për gjëra që i njohin ose i kanë parë, për gjëra që u kanë bërë përshtypje atyre ose shokëve të tyre. Në këtë rast, ata do të shkruajnë duke u nisur nga imagjinata dhe ndjeshmëria e tyre.

Në librin e klasës së tretë, siç e keni vënë re, ka mjaft tregime mbi bazën e figurave. Ato do të shërbejnë si bazë për zhvillimin e gjuhës së folur dhe të shkruar. Këtu është e rëndësishme prania dhe mbështetja e mësuesit.

Është synuar, që ngjarjet e treguara përmes figurave të jenë të thjeshta, interesante dhe të kuptueshme. Nxënësit duhet të aftësohen gradualisht, të dallojnë figurat nga njëra-tjetra, detajet e çdo figure dhe, mbi këtë bazë, të përcaktojnë përmbajtjen në tërësi. Tregimet me figura zhvillojnë aftësinë për të vështruar, për të analizuar lidhjet dhe marrëdhëniet ndërmjet dukurive, si edhe për të nxjerrë përfundime.

Nxënësit duhet të përcaktojnë objektet dhe personazhet e tregimit, veçoritë themelore të tyre dhe veprimet që kryejnë. Duhet synuar që nxënësit të flasin dhe të shkruajnë qartë me fjali të shkurtra, gjuhësisht të rregullta, me një fjalor që vjen duke u zgjeruar gradualisht.

Ata duhen ndihmuar, të dallojnë e të fiksojnë përmbajtjen e çdo figure dhe pastaj

radhën e tyre logjike. Më pas, bashkë me fëmijët, mbi bazën e pyetjeve që shoqërojnë figurat, do të arrihet të formulohet përmbajtja e tekstit në tërësi. Nxënësit duhet të nxiten gjithashtu, të gjykojnë për ngjarjet, për dukuritë dhe për veprimet e treguara përmes figurave, si edhe të shprehin ndjenjat e tyre në raport me to.

Punët me shkrim janë një aspekt tjetër i rëndësishëm i procesit mësimor në klasën e tretë. Ato duhen kuptuar si një mjet komunikimi i fëmijës me të tjerët. Prandaj, është e rëndësishme, që t'i jepen mundësitë fëmijëve ta përdorin e përsosin gradualisht këtë mjet shumë të rëndësishëm të komunikimit. Mësuesi ka për detyrë t'i nxitë e inkurajojë vazhdimisht nxënësit në këtë drejtim. Është mirë që nxënësit ta zgjedhin vetë temën për të cilën do të shkruajnë. Është një rast për të provuar e verifikuar veten, aftësitë për të dhënë një përmbajtje të caktuar, për të parashtruar ide, për të shkruar me një gjuhë të saktë nga ana gramatikore e drejtshkrimore, për t'u paraqitur para një publiku të caktuar shoqëror (shokëve të klasës ose më gjerë). Në këtë mënyrë, fëmijëve u krijojmë mundësinë, që të shkruajnë në këtë moshë për publikun; pra të aftësohen si krijues.

Kjo është një punë që do të vazhdojë gjatë gjithë shkollimit të tyre, po bazat e këtij formimi fillojnë që në këtë moshë, prandaj duhet vlerësuar e mbështetur me ta gjitha mundësitë.

Në këtë mënyrë, ju do të edukoni gradualisht tek fëmijët dashurinë për shkrimin dhe do t'i aftësoni ta kuptojnë atë si burim kënaqësie dhe si mjet komunikimi.

Duhet të bisedoni me fëmijët para se të fillojnë të shkruajnë, t'u bëni pyetje për përmbajtjen e asaj që do të shkruajnë, për të dhënat kryesore që do të paraqesin, për zhvillimin e ngjarjeve etj. Edhe pas variantit të parë të shkrimit duhet të bisedoni me to, t'i ndihmoni të gjejnë mungesat, gabimet dhe t'i ndreqin vetë ato.

Në pjesën e dytë të *Fletores së punës*, ka ushtrime të ndryshme që bëjnë të mundur përvetësimin e asaj që është mësuar, zhvillimin e të menduarit logjik dhe krijues të nxënësit.

## Pjesa e tretë

Pjesa e tretë përmbledh tekste jo artistike (*Toka rrotullohet, Edhe Hëna rrotullohet, Dhëmbët tanë, Përse na prishen dhëmbët, Nora nuk kujdeset për dhëmbët, Domatja, Speci, Molla, Krapë, Liqeni i Shkodrës, Qefulli, Shqiponja, Viti i Ri, Dikur ishte fushë, Lahuta, Çiftelia me dy tela*) që flasin për botën që na rrethon, pra, për për tokën, hënën, kafshët, bimët, festat, qytetet, veglat etj.

Gjatë zgjedhjes së teksteve, kemi pasur parasysh që të zgjedhim tekste joletrare me tematikë të përshtatshme për moshën, për aftësitë e tyre njohëse dhe interesante për moshën e tyre. Kemi synuar që të gjejmë tekste që trajtojnë probleme të jetës së përditshme. Po qe se gjykoni se tekstet e zgjedhura duhen redaktuar nga kjo ose ajo pikëpamje, ju mund ta bëni këtë, po duhet të ruani të dhënat. Tekstet janë nxjerrë nga enciklopeditë për fëmijë, nga Interneti etj. Kur e kemi gjykuar të nevojshme, tekstet i kemi modifikuar e përshtatur.

Pas çdo teksti vijnë pyetjet që u japin mundësi të punoni për të zhvilluar më tej tek fëmijët aftësinë për të analizuar dhe për të kuptuar tekste joletrare.

E rëndësishme gjatë analizës së teksteve është që nxënës-it/et jo vetëm të kuptojnë përmbajtjen ose idenë kryesore të tekstit, por të dinë edhe ta ndajnë tekstin në pjesët e tij përbërëse dhe të kuptojnë lidhjen që ekziston ndërmjet tyre.

Në tekst jepen detyra të llojeve të ndryshme, me karakter perceptues, analizues, krahasues, interpretues etj. Ndër të tjera, kërkohet: të renditin logjikisht pjesët e një teksti, të përmbledhet teksti me fjalët e tyre, t'i vënë një titull çdo pjese të tekstit dhe pastaj tekstit në tërësi, t'i paraqesin të dhënat e teksteve përmes tabelash, grafikësh etj., të bëjnë vlerësimin e të dhënave në tekst si të vlefshme ose të pavlefshme, të krahasojnë tekstin e lexuar me tekste të tjera të ngjashme, të gjejnë pikat e përbashkëta dhe dallimet, të ilustrojnë tekstet me vizatime, të shkruajnë tregime mbi bazën e figurave, të vazhdojnë e përfundojnë një tekst, të

tregojnë tekste që kanë tematikë të ngjashme me tekstin e lexuar.

Synimi përfundimtar i tërë punës me leximin është që nxënësit të arrijnë ta kuptojnë mirë tekstin dhe ta mbajnë mend. Për arritjen e këtyre dy synimeve është me rëndësi që nxënësit të aftësohen gradualisht të bëjnë planin e pjesës.

Para fillimit të analizës së një teksti joletrar, duhet t'i pyesim nxënësit se çfarë dinë ata për problemin që trajtohet në tekstin që do të lexohet. Mund të shkruhen në tabelë ato që thonë fëmijët. Pas kësaj, në qoftë se është fjala, për shembull, për përshkrimin e mollës mund grupohen pohimet e tyre sipas një kriteri logjik në disa të dhëna, kategori ose aspekte themelore; bima e mollës, trupi, gjethet, lulet; fruta e mollës, forma, ngjyra, madhësia, shija etj.

Kjo u jep mundësi nxënësve, të dallojnë të dhënat kryesore nga ato jo kryesore dhe t'i rendisin ato në mënyrë logjike, gjë që lehtëson kuptimin dhe mbajtjen mend të tekstit në përgjithësi.

Për ta bërë mësimin interesant dhe për ta lidhur më mirë me aktualitetin, rekomandohet që mësuesi, sipas vlerësimeve të veta, ta pasurojë orën e mësimit me tekste nga aktualiteti me interes për fëmijët e kësaj moshe.

Mësimet e tjera të kësaj pjese, në përputhje me kërkesat e programit, u kushtohen njohurive për veçoritë e sistemit gjuhësor. Përmbajtja e njohurive për sistemin gjuhësor në këtë pjesë është vazhdim i njohurive të fituara në pjesën e parë dhe të dytë (*Emrat kanë gjini dhe numër, Mbiemrat kanë gjininë dhe numrin e emrave, Fjalë që zëvendësojnë emrat, Foljet ndryshojnë, Pjesët plotësuese të fjalisë*). Njohuritë që jepen dhe mënyra e trajtimit të tyre është praktikë gjuhësore. Ajo është në pajtim me veçoritë e zhvillimit mendor e psikologjik të fëmijëve të kësaj moshe.

Në vazhdim do të japim sugjerimet tona për ecurinë metodike që mund të ndiqet për arritjen e synimeve, po duke ua lënë juve plotësisht të drejtën për të vendosur përfundimisht për realizimin konkret të saj në përputhje me veçoritë e klasës suaj dhe të metodës suaj të punës.

Po kështu, ju do të hartoni vetë testet, të cilat do të punohen në fund të çdo kapitulli dhe në përfundim të lëndës, me qëllim verifikimin e njohurive të fituara dhe të shkallës së përvetësimit. Për testet mund të udhëhiqeni nga tipat e ushtrimeve të parashtruara në Fletoren e punës, por jeni të lirë të shkoni edhe më tutje, në varësi të veçorive të përvetësimit të lëndës nga nxënësit e klasës suaj.



**ECURIA METODIKE PËR  
REALIZIMIN E SYNIMEVE**

## Ne flasim shqip, po Marina ...

---

---

**Synimi:** të kuptojnë që gjuha shqipe është gjuha amtare e tyre siç është malazishtja për malazezët.

**Janë të nevojshme:** dy biseda të regjistruara në magnetofon, një në shqip dhe një në malazisht nga radioja ose televizioni. Mund të sillen edhe libra ose gazeta në të dy gjuhët.

### Ora e parë

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- udhëzon nxënësit të dëgjojnë dy regjistrimet që ka përgatitur në shqip dhe malazisht. I pyet në çfarë gjuhe janë, a i kuptojnë, pse e kuptojnë regjistrimin e parë, kurse të dytin me pak, etj. Vijon bisedën për gjuhën që flasin ata dhe për gjuhën që flasin fëmijët malazezë. I pyet, pse ata flasin e shkruajnë ndryshe nga malazezët etj. Vazhdimësia e bisedës do të varet nga shkalla e interesimit të nxënësve dhe koha në dispozicion të mësuesit.
- fton nxënësit të vështrojnë e lexojnë tekstet *Zana dhe Agimi* dhe *Marina dhe Zorani*, Librin e nxënësit fq...;
- bën pyetjet: *Kush flet në bisedën e parë? A e kuptoni për çfarë flasin? Pse e kuptoni? Në çfarë gjuhe flasin Zana dhe Agimi? Kush flet në bisedën e dytë? A e kuptoni për çfarë flasin? Pse e kuptoni më pak? Në çfarë gjuhe flasin Marina e Zorani? Pse Marina e Zorani flasin gjuhë të ndryshme nga Zana dhe Agimi?*
- mund të vijohet me pyetje që lidhen me alfabetin e përdorur në të dy gjuhët, duke marrë shkas nga revista ose gazeta në të dy gjuhët, po pa kaluar masën dhe interesimin e fëmijëve;
- nxirret përfundimi se në Mal të Zi flitet dhe shkruhet, edhe në gjuhën shqipe, edhe në gjuhën zyrtare.

### Ora e dytë

**Synimi:** të përforcojnë dhe të zgjerojnë shkallën e njohurive për gjuhën amtare dhe përdorimin e saj.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- fton nxënësit të vështrojnë Librin e nxënësit faqe... ;
- bën pyetjet: *Në cilat treva të Malit të Zi flitet gjuha shqipe? Cili është kryeqyteti i Malit të Zi? Çfarë dini ju për Cetinjën? Çfarë dini ju për Podgoricën?*
- u thotë të lexojnë tekstet *Cetinja* dhe *Podgorica* në Librin e nxënësit fq. 7;
- u kërkon të thonë, çfarë kanë mësuar të re për Cetinjën dhe Podgoricën;
- kërkon nga nxënësit të zgjidhin ushtrimet 1-3 në Fletoren e punës faqe 6.

**Vërejtjet e mësues-it/es:**

## Në shtëpi dhe në shkollë

---

---

**Synimi:** të kuptojnë se gjuha ndryshon në varësi të mjedisit shoqëror, pra, se nuk flasim në shkollë si në shtëpi, si edhe të kuptojnë nocionet gjuhë letrare dhe gjuhë joletrare.

**Janë të nevojshme:** dy biseda të regjistruara në magnetofon, një joletrare në familje dhe një letrare nga radioja ose televizioni.

### Ora e parë

#### Veprimtaritë e mësues-it/es:

- udhëzon nxënësit, të dëgjojnë incizimet që ka përgatitur, njëri në gjuhën letrare dhe tjetri në gjuhën joletrare dhe të dallojnë bashkëbiseduesit në të dy rastet;
- kërkon nga nxënësit të thonë, nëse ka dallime në mes bisedës së parë dhe të dytë dhe të thonë, nëse në shtëpi ose me miqtë flitet, ashtu si flitet në radio dhe televizion;
- fton nxënësit të vështrojnë dy bisedat në Librin e nxënësit fq. 8;
- bën pyetjet: *Kush flet në bisedën e parë? Me ke flet? Kush flet në bisedën e dytë? Me ke flet? Çfarë ndryshimesh vini re në këto dy biseda? Pse ndryshojnë ato?;*
- nxjerrin përfundimet, në shkollë nuk flasim si në shtëpi, që nëna dhe fëmijët në shtëpi flasin në gjuhë joletrare (thonë *Si keni ndje?* në vend të *Si u gdhitë?*, *Duhet të çoheni* në vend të *Duhet të ngriheni*; *nanë* në vend të *nënë*), që mësuesja dhe fëmijët në shkollë flasin në gjuhë letrare, që gjuhë letrare është gjuha që përdoret në shkollë, në punë, në radio dhe televizion etj., që ajo ka rregullat e veta. të cilat ata do t'i mësojnë gradualisht në shkollë.

### Ora e dytë

**Synimi:** të përforcojnë dhe të zgjerojnë shkallën e njohurive për gjuhën letrare dhe të fitojnë njohuritë fillestare për praninë e fjalëve të huaja e të panevojshme në gjuhën shqipe.

#### Veprimtaritë e mësues-it/es:

- fton nxënësit të lexojnë dialogun në Librin e nxënësit në fq. 9;
- bën pyetjet: *Çfarë kuptimi kanë fjalët buqetë, tavolinë? Si mund të thuhet ndryshe? Çfarë fjalësh janë ato?;*
- u thotë, se ato janë fjalë që kanë hyrë në gjuhën shqipe nga gjuhë të tjera dhe se në vend të tyre në gjuhën shqipe mund të përdoren fjalët *tufë* dhe *tryezë*;
- u kërkon nxënësve, të vështrojnë në Librin e nxënësit fq. 9 tabelën me fjalë të huaja dhe shqipe, të cilën mund ta shkruajë edhe në tabelë;
- bën pyetjet: *Çfarë fjalësh janë fjalët e kolonës së parë? Po ato të kolonës së dytë?* nxjerrin përfundimin, se në gjuhën shqipe ka fjalë të huaja, se ato janë dukuri e të gjitha gjuhëve dhe se nuk është mirë të përdorim fjalën e huaj, kur ekziston fjala shqipe, pra jo *tavolinë*, por *tryezë*, jo *doktor*, por *mjek*, jo *sahat*, por *orë* etj.;
- kërkon nga nxënësit të zgjidhin ushtrimet 1-4 në Fletoren e punës fq. 7-8.

**Shënim:** për detyrat e shtëpisë që mund të japë eventualisht, mësuesi është i lirë të vendosë vetë në varësi të kërkesave dhe të mundësive të fëmijëve. E rëndësishme është që detyrat e shtëpisë të jenë të arsyeshme dhe të menduara mirë.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Bisedojmë me njëri-tjetrin

---

---

**Synimi:** Përvetësojnë disa parime bazë të komunikimit përmes dialogut. Fëmijët duhet të mësojnë se nuk duhet t'ua ndërpresin fjalën bashkëbiseduesve në një dialog dhe nuk duhet të ndërhyjnë pa vend, kur të tjerët bisedojnë.

**Është e nevojshme:** një bisedë e regjistruar në magnetofon ku një fëmijë ndërhyr pa vend dhe ua pret bisedën dy shoqeve të veta.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- udhëzon nxënësit të dëgjojnë incizimin që ka përgatitur, në të cilin një fëmijë ua pret pa vend bisedën dy shoqeve të veta;
- bën pyetjet: *Kush flet? Me kë flet? Çfarë nuk ju pëlqen në këtë bisedë? Si do të vepronit ju në këtë rast?*;
- i fton nxënësit të vështrojnë bisedën në Librin e nxënësit fq. 10;
- bën pyetjet: *Kush po flet me shitësen? Kush e ndërpret? Si i përgjigjet shitësja? A vepron drejt Tomi? Po shitësja a ka të drejtë që i lutet të presë? Si do të vepronit ju në këtë rast? Pse nuk duhet të veprojmë si Tomi;*
- nxjerrin përfundimet, se biseda midis dy ose më shumë njerëzish është një dialog, që ata që flasin quhen bashkëbisedues, që kur dy vetë janë duke folur nuk duhet t'ua presim bisedën;
- u kërkon të lexojnë tekstin “Vizatuesja e vogël”.
- bën pyetjet : *Kush flet në këtë tekst? Me kë flet? Çfarë kërkon vajza? Si i përgjigjet e ëma? Pse i kërkoi gërshërët? Përse donte të bënte kafaz për ujkun? Çfarë mendimi keni për vajzën?* ;
- nxjerrin përfundimin, se, kur dy ose më shumë vetë flasin me njëri-tjetrin, themi se ata bisedojnë, se bashkëbiseduesit flasin për atë që duan, se kur flasim, bashkëbiseduesin duhet ta dëgjojmë me vëmendje, se mendimin duhet ta shprehim shkurt dhe pa përsëritje. Këto rregulla dhe ato të mësipërmet mund të shkruhen në një vend të dukshëm dhe të respektohen nga të gjithë;
- kërkon nga nxënësit të zgjidhin ushtrimet 1-3 në Fletoren e punës fq. 9-10.

**Shënim:** në orët në vazhdim mësuesi mund të organizojë lojën me role gjatë së cilës do t'ua kërkojë nxënësve të bisedojnë në situata në të cilat respektohen rregullat, po edhe në situata në të cilat ato nuk respektohen.

**Vërejtjet e mësues-it/es:**

## Alo, mirëdita ...

---

---

**Synimi:** Përvetësojnë e thellojnë disa parime bazë të komunikimit përmes dialogut. Për këtë do të zhvillohen biseda telefonike dhe do të kërkohet të respektohen rregullat e komunikimit me telefon siç janë mënyra e prezantimit dhe e përshëndetjes në telefon.

**Është e nevojshme:** një bisedë telefonike e regjistruar në magnetofon, ku bashkëbiseduesit flasin shpejt dhe duke bërë titur dhe nuk përdorin fjalët: *mirëdita, ju lutem, faleminderit, mirupafshim*.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- u kërkon nxënësve të tregojnë, si komunikojnë njerëzit me njëri-tjetrin, me çfarë mjetesh (letra, telefon, internet); si veprojnë ata, kur bie zilja e telefonit etj.
- udhëzon nxënësit, të dëgjojnë incizimin e përgatitur, ku fëmijët flasin shpejt dhe duke bërë titur dhe nuk përdorin fjalët: *mirëdita, ju lutem, faleminderit, mirupafshim*;
- bën pyetjet: *Kush flet? Me kë flet? Çfarë nuk ju pëlqen në këtë bisedë? Si do të vepronit ju në këtë rast?*;
- u thotë nxënësve, të lexojnë me zë bisedën telefonike të Verës me familjen Gjonaj në Librin e nxënësit, fq. 12;
- bën pyetjet *Kush flet? Me kë flet? Si e fillon bisedën Vera? Me çfarë fjalësh u drejtohet prindërve të Vjollcës? Si e përshëndet ajo?*
- u tërheq vëmendjen në momentet e rëndësishme të bisedës siç janë: përshëndetja në fillim të bisedës, prezantimi, thirrja e bashkëbiseduesit tjetër ... etj.;
- u thotë nxënësve, të lexojnë me zë bisedën tjetër telefonike të Verës me Vjollcën në Librin e nxënësit fq. 13;
- bën pyetjet: *Kush flet? Me kë flet? Si e fillon bisedën Vera me shoqen e saj, Vjollcën? Si i drejtohet ajo shoqes së saj? Si e përshëndetin ato njëra-tjetrën në fund të bisedës?*;
- u tërheq vëmendjen në momentet e rëndësishme të bisedës siç janë: përshëndetja në fillim të bisedës, mënyra si i drejtohen dhe si përshëndetin njëra-tjetrën në fund;
- nxjerrin përfundimin se, kur bie zilja e telefoni, duhet ta kapim pa vonesë, të mos e lëmë të vazhdojë të bjerë, se nuk duhet ta afrojmë telefonin te goja, se nuk duhet të flasim shpejt ose të bërtasim dhe se nuk duhet të harrojmë të përdorim fjalët: *mirëdita, ju lutem, faleminderit, mirupafshim* etj.;
- kërkon nga nxënësit të zgjidhin ushtrimet 1-3 në Fletoren e punës fq. 11.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Dua të telefonoj ...

---

---

**Synimi:** të njohin veçoritë dhe mënyrën e përdorimit të numërorit telefonik dhe të ushtrohen të përgatisin vetë blloqe a fletore që shërbejnë si numërorë telefonikë.

**Janë të nevojshëm:** numërorë telefonikë dhe blloqe që shërbejnë për shënimin e numrave të telefonit.

### Ora e parë

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- u kërkon nxënësve, të tregojnë si veprojnë për të gjetur një numër telefoni që ju duhet;
- bën pyetjet: *Ç'është numërori telefonik? A keni ju në shtëpi numëror telefonik? Si e gjeni ju një numër telefoni në numëror? Po kur nuk keni numëror telefonik, si veproni për të mos i harruar numrat e telefonit të shokëve dhe të miqve?;*
- fton nxënësit, të lexojnë tekstin “*Dua të telefonoj*” në Librin e nxënësit në fq. 14;
- bën pyetjet: *Çfarë i kërkon mamit Edlira? Pse ia kërkon? Si vepron ajo për ta gjetur numrin e telefonit të Blerinës?;*
- u tregon numërorin telefonik dhe diskutojnë për mënyrën e përdorimit;
- nxjerrin përfundimin, se nuk është e lehtë të mbahen mend të gjithë numrat telefonikë që na duhen, prandaj është mirë të kemi numërorin telefonik, se numërori telefonik është një libër i shtypur në shtypshkronjë, ku janë shënuar sipas alfabetit të gjithë numrat telefonikë të një qyteti, se ai blihet në postë ose në librari, se numrat e telefonit mund t'i shënojnë edhe në një fletore të thjeshtë ose në fletoret që shiten për këtë qëllim. Numrat e telefonit mund të shënohen edhe në telefonat celularë;
- u kërkon të gjejnë në numërorin telefonik numrat e Policisë, të Zjarrfikësve dhe të Urgjencës, etj.;
- udhëzon për mënyrën e shkrimit të numrave telefonikë në numërorin telefonik personal (blloku ose fletorja personale). Shkruajnë sipas rendit alfabetik emrin dhe mbiemrin e personit dhe pastaj numrin e telefonit;
- jep detyrë të shënojnë numrat telefonikë të shokëve dhe të shoqeve të klasës në numërorin e tyre personal.

### Ora e dytë

**Synimi:** të përforcojnë njohuritë për mënyrën e përdorimit të numërorit telefonik dhe të ushtrohen të përgatisin vetë një “telefon” të thjeshtë me mjete rrethana.

**Janë të nevojshme:** gota kauçuku , spango dhe gozhdë.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- fton nxënësit, të paraqesin regjistrat e vet telefonikë dhe të tregojnë sesi përdoren;
- bëjnë vlerësimin e fletoreve të secilit, duke bërë edhe vërejtje për ndreqje, kur gjykohet e arsyeshme;
- ndan nxënësit në grupe dhe u thotë, se tani do të përgatitin në grupe telefonin;
- nxënësit përgatisin telefonin sipas udhëzimeve në fq. 12 të Fletores së punës;
- fton çiftet, të dalin vullnetarisht dhe të demonstrojnë përdorimin e telefonit, duke folur për ndonjë problem sipas dëshirës;
- bëhet vlerësimi i bisedës nga nxënësit që dëgjojnë.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**



## Si të ftojmë?

---

---

**Synimi:** të aftësohen nxënësit të lexojnë e kuptojnë tekste jo letrare. Do të njohin veçoritë e ftesës, pra, si shkruhet një ftesë dhe me çfarë rasti bëhet.

### Ora e parë

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- kërkon nga nxënësit, të flasin për ditëlindjet e veta, kur i kanë, si i festojnë, kë ftojnë etj.
- i fton nxënësit/et të tregojnë përvojat e veta lidhur me shkrimin e ftesave (me çfarë rasti i kanë shkruar, çfarë kanë shkruar, kujt ia kanë dërguar, si ia kanë dërguar etj. )
- fton nxënësit të lexojnë tekstin “*Andi fton shokët*” në Librin e nxënësit fq. 15;
- bën pyetjet: *Kush e dërgon ftesën? Kujt ia dërgon? Për çfarë veprimtarie? Kur zhvillohet veprimtaria? Ku zhvillohet?*;
- bën pyetjen: *Çfarë duhet të përmbajë ftesa?*;
- nxjerrin përfundimin, se ftesa duhet të përmbajë: emrin dhe mbiemrin e dërguesit, emrin dhe mbiemrin e marrësit, shkakun e organizimit të festës, datën e organizimit të festës, orën e fillimit të veprimtarisë, adresën ku do të zhvillohet, numrin e telefonit të atij që e organizon festën;
- u thotë nxënësve të zhvillojnë detyrat 1 dhe 2 në Fletoren e punës, fq. \_\_\_\_ .

### Ora e dytë

**Synimi:** përforcojnë njohuritë për veçoritë e ftesës; si shkruhet dhe për ç’raste dërgohet.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- u jep detyrë nxënësve të lexojnë në Librin e nxënësit, fq. \_\_\_\_ ftesën për ekspozitën e pikturës;
- bën pyetjet: *Kush e dërgon ftesën? Për çfarë veprimtarie? Çfarë të dhënash janë shkruar? Në ç’orë duhet të mbërrijnë në ekspozitë? Përse në këtë ftesë nuk është emri i atij, të cilit i drejtohet ftesa? A është gjithmonë kështu?*;
- nxjerrin përfundimet, se, kur duam që dikush të marrë pjesë në një festë, i bëjmë ftesë dhe se ftesa duhet të përmbajë të gjitha të dhënat e që kemi mësuar.
- pyet nxënësit, si duhet të veprojmë pasi të marrim një ftesë;
- ndan nxënësit në tri grupe dhe i fton të lexojnë secili njërin nga tri tekstet joletrare që vijnë në Librin e nxënësit, fq. 16;
- pyet nxënësit: *Kush është dërguesi dhe kush është marrësi në secilin prej tyre? Çfarë bën dërguesi në secilin prej tyre: E fton marrësin në veprimtarinë që do të zhvillohet? E falënderon marrësin dhe pohon pjesëmarrjen? I kërkon falje që nuk do të marrë pjesë?*
- nxjerrin përfundimin, se, kur marrim një ftesë, duhet ta njoftojmë dërguesin, se e kemi marrë ftesën dhe a do të marrim apo s’do të marrim pjesë, pa harruar ta falënderojmë për ftesën;
- kërkon që të zhvillojnë detyrat 3-6 në Fletoren e punës, fq 14-15;
- fton nxënësit/et, të paraqesin vizatimet e veta dhe t’i ngjisin në stendën e afishimeve.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Afërdita ka ditëlindjen

---

---

**Synimi:** të aftësohen për të folur, për të menduar në mënyrë logjike dhe për krijuar tekste joletrare me gojë dhe me shkrim.

### Ora e parë

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- u kërkon nxënësve të flasin për mënyrën e festimit të ditëlindjeve të tyre; ku i festojnë, kur i festojnë, kë ftojnë, si ftojnë dhe çfarë bëjnë;
- u thotë të vështrojnë gjashtë figurat në Librin e nxënësit, fq. 17;
- i fton të flasin për përmbajtjen e çdo figure veç e veç;
- bashkë me nxënësit shënon nga një fjali për çdo figurë, të cilat, së bashku, bëjnë pikat e planit të pjesës;
- pikat e planit nxënësit i shkruajnë edhe në fletoren e tyre;
- u kërkon ta ritregojnë ngjarjen në bazë të pikave të planit, të nxjerra prej tyre.

### Ora e dytë

**Synimi:** të aftësohen për të folur, për të menduar në mënyrë logjike dhe për krijuar tekste joletrare me shkrim.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- kërkon të lexojnë pikat e planit të nxjerra nga ora e kaluar;
- fton ta ritregojnë përmbajtjen sipas pikave të planit;
- kërkon të shkruajnë në Fletoren e punës, fq. 16 një tekst për ditëlindjen e Afërditës, duke u nisur nga figurat në Librin e nxënësit fq. 17.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Tregim sipas figurave

---

---

**Synimi:** të aftësohen për të folur, për të menduar në mënyrë logjike dhe për të krijuar tekste jo letrare me gojë dhe me shkrim.

### Ora e parë

#### Veprimtaritë e mësues-it/es:

- bën bisedë me nxënësit për shenjat rrugore. U kërkon të thonë, përse shërbejnë, çfarë shënojnë tri ngjyrat kryesore, pse duhen respektuar, a i respektojnë ata shenjat rrugore etj.;
- kërkon që ndonjëri të tregojë edhe ndonjë ngjarje që lidhet me to e që mund t'i ketë ndodhur atij ose shokëve të tij;
- u kërkon të vërejnë figurat në Librin e nxënësit, fq. 18;
- ndan nxënësit në tri grupe dhe çdo grup jep shpjegimin e vet për çdonjërin nga figurat;
- u kërkon të lexojnë në Fletoren e punës, fq. 17 pjesën që u përgjigjet dy figurave të para;
- kërkon që secili grup të shkruajë vazhdimin e tregimit dhe t'i vërë një titull.
- ndjek punën e grupeve dhe jep ndihmën e nevojshme.

### Ora e dytë

**Synimi:** të aftësohen për të folur, për të menduar në mënyrë logjike dhe për të krijuar tekste jo letrare me shkrim.

#### Veprimtaritë e mësues-it/es:

- i kërkon çdo grupi të lexojë çfarë ka shkruar; të tjerët bëjnë vërejtjet dhe sugjerimet e tyre;
- teksti original paraqitet ky që vijon:

#### Mos biri im!

Dritani po shkonte në kinema, por ishte vonë.

Pas dhjetë minutash dera e kinemasë do të mbyllej. Dritani nisi të vraponte. Por, ah, ç'dëshpërim!...

Në kryqëzimin e të katër udhëve, u hap drita e kuqe e semaforit. Dritani ndaloi.

- Sa është ora? - pyeti i shqetësuar një burrë.

- Pesë pa tetë minuta! - iu përgjigj ai.

- Bobo, s'do të arrij dot! - tha Dritani me vete. - Duhet të kaloj para se të hapet drita jeshile.

U mat të kapërcente rrugën, por një dorë i kapi krahun.

I habitur, fëmija ktheu kokën.

- Mos, biri im! Ki mendjen! Një nxitim i tillë të kushton jetën!

- Do të humbas filmin! - thirri Dritani i dëshpëruar.

- Të ishe nisur më parë! - i tha burri e nga xhepi i palltos nxori "dorën", mëngën boshe.

I tronditur fëmija u zbraps.

Burri i panjohur i tha.

- Dikur, në vend të kësaj mënge boshe, kisha një dorë. Një ditë nxitova kështu si ti. Nuk prita të kalonte makina. Nxitova të kaloj në trotuarin tjetër, por makina që kishte shpejtësi, më arriti shpejt.

Shoferi u mundua të frenonte, por s'frenoi dot. Dhe ja, tani jam me një dorë. Mund ta kisha pësuar edhe me keq, biri im!

I bindur, fëmija priti gjersa u hap drita jeshile.

- kërkon të bëhet korigjimi i shkrimeve nga secili grup veç e veç mbi bazën e vërejtjeve të bëra;
- ndihmon nxënësit sipas rastit dhe, kur e gjykon të nevojshme.
- u kërkon t'i lexojnë shkrimet e tyre të redaktuara dhe t'i vendosin në këndin e afishimit të klasës.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Si të urojmë?

**Synimi:** të aftësohen nxënësit të lexojnë e kuptojnë tekste joletrare. Do të njohin veçoritë e urimeve, pra, si shkruhet një urim dhe me çfarë rasti bëhet.

### Ora e parë

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- u kërkon nxënësve të flasin për urimet, i pyet në se ata kanë marrë urime, kush ua ka dërguar, përse i kanë uruar etj.;
- i pyet: *A keni dërguar ndonjë herë urime? Kujt i keni dërguar? Me ç'rast e keni dërguar? Çfarë i keni shkruar? Si e keni dërguar?;*
- fton të lexojnë urimet që kanë marrë Andi dhe Afërdita në Librin e nxënësit, fq. 20;
- bën pyetjet: *Me ç'raste janë dërguar këto dy urime? Si do të mund të bëheshin me gojë këto dy urime? Çfarë është urimi? Kur shkruhet një urim? Si dërgohet një urim?;*
- nxjerrin përfundimin, se urimi është një tekst me anën e të cilit, me gojë ose me shkrim, përgëzojmë të afërmit, miqtë dhe të njohurit tanë, se urimet bëhen për ditëlindje, për Vitin e Ri, për suksese në mësim, në punë ose ndonjë ngjarje tjetër të bukur, se urimi mund të dërgohet me postë ose të shkruhet edhe në një dhuratë që i bëhet dikujt.
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-3 në Fletoren e punës, fq. \_\_\_\_.

### Ora e dytë

**Synimi:** të aftësohen nxënësit të shkruajnë tekste joletrare. Do të njohin veçoritë e kartolinës, pra, si shkruhet një kartolinë dhe me çfarë rasti shkruhet.

**Janë të nevojshme:** kartolina urimi të llojeve të ndryshme.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- u kërkon nxënësve të flasin për kartolinat, i pyet në se ata kanë marrë kartolina, kush ua ka dërguar, me çfarë rasti ua kanë dërguar etj.;
- pyet, nëse i kanë dërguar ndonjë herë kartolinë, kujt ia kanë dërguar, me ç'rast e kanë dërguar, çfarë kanë shkruar dhe si e kanë dërguar;
- i fton të lexojnë dy kartolinat dërguar, njëra Elonës dhe tjetra mësueses, në Librin e nxënësit, fq. 20;
- bën pyetjet: *Kush e dërgon kartolinën e parë? Kujt ia dërgon? Çfarë i shkruan? Kush e dërgon kartolinën e dytë? Kujt ia dërgon? Çfarë i shkruan? A mungon diçka në kartolinën e dytë?;*
- nxjerrin përfundimin që për ta marrë kartolinën tënde ai, të cilit ti ia dërgon me postë, duhet të shkruash emrin dhe mbiemrin e marrësit dhe adresën e plotë të tij (*rruga, pallati, apartamenti, numri, kodi postar i qytetit, qyteti*). Poshtë përmbajtjes së urimit duhet të shkruash emrin tënd.
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 4-6 në Fletoren e punës fq. 19.

**Shënim:** ndarja e propozuar e mësimëve në orë mësimi, nuk është e detyrueshme për mësues-in/en, sepse çdo klasë ka veçantitë e saj dhe ritmet e veta të përvetësimit të njohurive dhe çdo mësues ka përvojën e vet. Pra, mësuesit janë plotësisht të lirë të vendosin vetë për sasinë dhe mënyrën e ndarjes së orëve për çdo mësim. Pra, nëse mësues-i/ja e sheh të nevojshme, mund të përdorë edhe një orë tjetër mësimi për këtë ose atë temë.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Ata morën fletëlavdërimi

---

---

**Synimi:** të aftësohen nxënësit të lexojnë dhe të shkruajnë tekste joletrare. Do të njohin veçoritë e lavdërimeve, kur bëhen, pse bëhen dhe si bëhen.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- u kërkon nxënësve të flasin për lavdërimet, i pyet, nëse ata janë lavdëruar, kush i ka lavdëruar, me çfarë rast i ka lavdëruar etj.;
- fton të lexojnë tekstin “Ata morën fletëlavdërimi” në Librin e nxënësit, fq. 22;
- bën pyetjet: *Çfarë morën Berti, Abi, Shpresa dhe Zamira? Pse morën ata fletëlavdërimi?*
- nxjerrin përfundimin që lavdërimet bëhen për njerëz që dallohen në mësim, punë ose aktivitete të ndryshme kulturore e sportive;
- ndan nxënësit në tri grupe dhe u kërkon të përgatisin nga një fletëlavdërimi për një çështje që do ta përcaktojnë ata vetë (nxënës i dalluar në mësim, klasë e pastër, rezultate të mira në takimet sportive etj. )
- fton të diskutojnë për fletëlavdërimet që kanë përgatitur.
- bëjnë ndreqjet e nevojshme dhe mund të organizojnë një ceremoni lavdërimesh për një problem, sipas traditës së shkollës ose klasës së tyre.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**



## Tregim sipas figurave

---

---

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të folur e për të menduar në mënyrë logjike si dhe të aftësohen të krijojnë tekste me gojë dhe me shkrim.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- zhvillon një bisedë paraprake me ta për dordolecin që bëhet me shkopinj, rroba të vjetra etj. dhe që vihet në kopshte për të trembur shpendët dëmtues dhe pas kësaj për dordolecin prej dëbore;
- u thotë nxënësve të shikojnë figurat në Librin e nxënësit, fq. 23;
- fton nxënësit të flasin për përmbajtjen e secilës prej figurave. Për këtë ka përgatitur më parë pyetjet përkatëse për çdonjërin nga figurat;
- për secilën figurë shkruan në tabelë nga një fjali që shpreh thelbin e përmbajtjes së figurës;
- kërkon të tregojnë përmbajtjen e tekstit në përgjithësi, duke pasur parasysh edhe fjalitë e shkruara në tabelë për secilën figurë.
- u thotë të propozojnë tituj të mundshëm për tekstin;
- shkruanë në tabelë titujt e propozuar dhe arrijnë në një përfundim për titullin më të preferuar.

### Ora e dytë

**Synimi:** të aftësohen nxënësit të shkruajnë tekste joletrare.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- u kërkon të shkruajnë tregimin në Fletoren e tyre të punës, fq. 20.
- bëhet leximi i disa prej shkrimeve dhe vlerësimi i tyre.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Flasim për programet televizive

---

---

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të folur e menduar në mënyrë logjike, për të lexuar e kuptuar tekste dhe për të bërë vlerësime e zgjedhje personale.

**Është i nevojshëm:** një program televiziv i botuar në gazetë.

### Ora e parë

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- zhvillon bisedë paraprake me fëmijët për televizorin, i pyet nëse i shohin programet televizive, sa kohë i kushtojnë televizorit, a kanë probleme me vëllezërit dhe motrat ose me të rriturit lidhur me këtë, në qoftë se po, ç'probleme kanë dhe si i zgjidhin ato;
- fton nxënësit të hapin Librin e nxënësit, fq. \_\_\_ dhe u kërkon të lexojnë tekstin “*Televizori ankohet*”;
- bën pyetjet: *Pse ankohet televizori? Çfarë duan të shikojnë babai, nëna dhe motra? Po djali i vogël, çfarë do të shikojë? Si i përgjigjet ai babait? Po ju si veproni në familjen tuaj? Si mendoni se mund të zgjidhet ky problem?*;

### Ora e dytë

**Synimi:** përforcojnë aftësinë për të folur e për të menduar në mënyrë logjike dhe për të bërë vlerësime e zgjedhje personale.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- kërkon të vështrojnë në Librin e nxënësit, fq. 25 figurën në vazhdim që paraqet programin televiziv në gjuhën shqipe të botuar në gazetë;
- bën pyetjet: *Çfarë është programi televiziv? Ku gjendet? Përse shërben?*
- fton nxënësit të hapin Librin e nxënësit, fq. 25 dhe u kërkon të vështrojnë figurën me programet për fëmijë të televizionit të Malit të Zi;
- bën pyetjet: *Çfarë programesh për fëmijët jepen në televizionin e Malit të Zi? Cili program ju pëlqen më shumë?* dhe u kërkon të flasin për njërin prej tyre që u ka pëlqyer më shumë.
- kërkon të zhvillojnë ushtrimet 1-4 në Fletoren e punës, fq. 21-22.
- u thotë të paraqesin punën e tyre dhe bëjnë vlerësimet përkatëse.

**Vërejtje.** Mësues-i/ja, nëse e sheh të nevojshme, mund të përdorë edhe një orë tjetër mësimi për këtë temë.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Tregim sipas figurave

---

---

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të folur, menduar në mënyrë logjike si edhe të aftësohen të krijojnë tekste mbi bazën e fantazisë së tyre, me gojë dhe me shkrim.

**Janë të nevojshme:** tregime fantastike me figura.

### Ora e parë

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- bisedon me fëmijët për tregimet fantastike të njohura nga fëmijët, të botuara ose të shfaqura në televizion. Fëmijët flasin për ndonjërin prej tyre. I pyet, nëse edhe ata ëndërrojnë të kenë diçka ose të bëjnë diçka të veçantë a të jashtëzakonshme;
- fton nxënësit të shikojnë figurat në Librin e nxënësit, fq. 26;
- ndan nxënësit në çifte dhe i udhëzon ta lexojnë tregimin dhe të bisedojnë me njëri-tjetrin rreth tij;
- shkon pranë çifteve, bisedon me fëmijët, u ndihmon dhe i këshillon;
- kërkon ta tregojnë përmbajtjen e tregimit para klasës.

### Ora e dytë

**Synimi:** përforcojnë aftësinë për të shkruar mbi bazën e fantazisë.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- fton nxënësit ta ritregojnë përmbajtjen e tregimit;
- u kërkon ta shkruajnë tregimin në Fletoren e punës, fq. 23 dhe u kërkon t'i vënë titullin që mendojnë;
- bëhet leximi i disa prej shkrimeve dhe vlerësimi i tyre nga nxënësit.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**





## Teksti dhe fjalia

---

---

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të folurit dhe për të lexuar e kuptuar tekste joletrare, të njohin veçoritë e tekstit dhe llojet e fjalive sipas kuptimit dhe formës: dëftore, pyetëse, thirrmore, pohore e mohore.

**Janë të nevojshëm:** lloje të ndryshme tekstesh nga letërsia për fëmijë, vjersha, tekste dramatike, artikuj gazetash etj.

### Ora e parë

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- ofron lloje të ndryshme tekstesh nga letërsia për fëmijë dhe fton të diskutojnë për shumëllojshmërinë e teksteve duke u ndalur në dallimet e tyre të jashtme (tekste në prozë, në poezi, dramë etj.);
- fton të lexojnë pjesë të shkurtra nga tekste të llojeve të ndryshme të letërsisë për fëmijë;
- u kërkon të lexojnë me radhë tekstet “*Edlira ka blerë kompjuter*” dhe “*Edlira është e gëzuar*” në Librin e nxënësit, fq. 28;
- bën pyetjet: *A kuptohen? Sa fjali ka secili?*;
- arrijnë në përfundimin, se një shkrim që lexohet e kuptohet, është një tekst, që teksti ka dy ose më shumë fjali;
- bën pyetjet: *Sa fjali ka në tekstin e dytë? Me çfarë shkronje fillojnë? Çfarë shenjash pikësimi kanë në fund?*;
- nxjerrin përfundimin që fjalia është një lidhje fjalësh që kanë kuptim, që fjalia fillon me shkronjë të madhe dhe mbaron me pikë, pikëpyetje ose pikëçuditje;
- u kërkon të zhvillojnë ushtrimet 1-2 në Fletoren e punës, fq. 26.

### Ora e dytë

**Synimi:** të dallojnë fjalitë sipas kuptimit: dëftore, pyetëse, thirrmore.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- fton nxënësit/et të lexojnë bisedën midis Edlirës dhe Dritanit në Librin e nxënësit, fq. \_\_;
- bën pyetjet: *A ndryshojnë fjalitë e mësipërme nga njëra-tjetra? Nga e kuptoni? Çfarë bëjmë në fjalinë e parë: tregojmë, pyesim, shprehim një ndjenjë (gëzim, kënaqësi, habi)? Po në fjalinë e dytë, të tretë, të katërt çfarë bëjmë?*;
- nxjerrin përfundimin, se fjalitë nga kuptimi mund të jenë, dëftore, pyetëse, thirrmore, që fjalitë dëftore tregojnë diçka dhe marrin pikë në fund, që fjalitë pyetëse pyesin për diçka dhe marrin në fund pikëpyetje, që fjalitë thirrmore shprehin një ndjenjë (gëzim, kënaqësi, habi) për diçka dhe marrin në fund pikëçuditje;
- jep detyrë që të shkruajnë tri fjali sipas përmbajtjes së figurave në Librin e nxënësit, fq. \_\_; fjalitë duhet të jenë të ndryshme për nga kuptimi;
- fton nxënësit/-et që të lexojnë fjalitë që kanë shkruar;
- kërkon të bëjnë ushtrimet 3-5 në Fletoren e punës, fq. 27.

### Ora e tretë

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të dalluar fjalitë sipas formës, pohore dhe mohore.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- fton nxënësit/et të lexojnë fjalitë “*Unë kam kompjuter.*” dhe “*Unë nuk kam kompjuter.*” në Librin e nxënësit, fq. 30;
- bën pyetjet: *Çili është kuptimi i fjalisë së parë? Cili është kuptimi i fjalisë së dytë? Çfarë*

*dallimi vini re ndërmjet tyre? Si quhet fjalia e parë? Si quhet fjalia e dytë?;*

- nxjerrin përfundimin, se fjalitë mund të jenë pohore dhe mohore, se fjalitë mohore kanë kuptim të kundërt me fjalinë pohore;
- kërkon të vështrohet pasqyra me fjali pohore dhe mohore në Librin e nxënësit fq. 30;
- bën pyetjet: *Fjalitë e kolonës së parë janë pohore apo mohore? Po fjalitë e kolonës së dytë? Ku dallohen ato nga njëra-tjetra?;*
- nxjerrin përfundimin, se fjalitë mohore zakonisht marrin *nuk* përpara foljes.
- kërkon të zhvillohen ushtrimet 6-9 në Fletoren e punës, fq. 28-29.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Guri i Skënderbeut

---

---

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të folurit dhe për të lexuar e kuptuar tekste të shkruara; të dallojnë fjalitë sipas kuptimit dhe sipas formës.

### Ora e parë

#### Veprimtaritë e mësues-it/es:

- pyet nxënësit, se ç'dinë për Skënderbeun dhe u kërkon të flasin për jetën dhe veprat e tij aq sa mund të dinë; i pyet, nëse kanë dëgjuar diçka për shpatën e tij etj.;
- kërkon të lexohet teksti “Guri i Skënderbeut” në Librin e nxënësit, fq. 31;
- bën pyetjet: *Çfarë porositi Skënderbeu? Për çfarë bisedon me farkëtarin? Çfarë bëri Skënderbeu për të provuar shpatën e re? Çfarë i tha mjeshtrit, pasi e provoi shpatën? Si quhet shkëmbi ku Skënderbeu provoi shpatën ?;*
- u kërkon të thonë me fjalët e tyre përmbajtjen e tekstit;
- bën pyetjet: *Kush flet në këtë tekst? Me kë flet? Çfarë shenjash pikësimi ka në fund të fjalive të këtij teksti? Pse ndryshojnë shenjat e pikësimit nga një fjali në tjetrën?; Çfarë tregojnë fjalitë që mbarojnë me pikë? Çfarë tregojnë fjalitë që mbarojnë me pikëpyetje? Çfarë tregojnë fjalitë që mbarojnë me pikëçuditje?;*
- ritheksohet përfundimi, se, për nga kuptimi, fjalitë mund të jenë, dëftore, pyetëse, thirrmore dhe vihen në dukje veçoritë e tyre.

#### Vërejtjet e mësues-it/-es:



## Fjalë që tregojnë njerëz, kafshë dhe sende

**Synimi:** të dallojnë fjalët që tregojnë njerëz, kafshë, sende, pra, të dallojnë emrat e njerëzve, të kafshëve dhe të sendeve, si edhe emrat e përveçëm e të përgjithshëm.

### Ora e parë

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- zhvillon me nxënësit një bisedë nëse mbajnë në shtëpi qen, mace etj, i pyet se si quhen ato. I shkruan në tabelë emrat e kafshëve që kanë në dy rubrika të veçanta;
- nxjerrin përfundimin, se fjalët që shënojnë si quhen kafshët që mbajnë në shtëpi, tregojnë kafshë;
- fton nxënësit/et të lexojnë tekstin për qenin e Fatmirës në Librin e nxënësit, fq. 32;
- kërkon të gjejnë fjalët që tregojnë njerëz, kafshë, sende dhe i shkruan në tabelë;
- nxjerrin përfundimin, se fjalët: *Fatmira, shok, mësuese* tregojnë njerëz, se fjalët : *qen, Lupi* tregojnë kafshë dhe se fjalët: *shtëpi, shkollë* tregojnë sende;
- pyet: Çfarë janë fjalët që tregojnë njerëz, kafshë, sende?;
- nxjerrin përfundimin, se fjalët që tregojnë *njerëz, kafshë, sende* janë *emra*;
- kërkon të shihen figurat në vazhdim dhe grupet e emrave që tregojnë njerëz, kafshë, sende në Librin e nxënësve fq. 32;
- bën pyetjet: *Çfarë tregojnë fjalët e grupit të parë? Çfarë tregojnë fjalët e grupit të dytë? Çfarë tregojnë fjalët e grupit të tretë?;*
- nxjerrin përfundimin, se fjalët *kuzhinier, shofer, mjek* tregojnë njerëz, se fjalët *mace, qen, lepur* tregojnë kafshë, se fjalët *sharrë, piano, fustan* tregojnë sende, se fjalët që tregojnë njerëz, kafshë, sende, janë emra;
- kërkon të zhvillohen ushtrimet 1-3 në Fletoren e punës, fq. 30-31.

### Ora e dytë

**Synimi:** të dallojnë emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- fton nxënësit të thonë emrat e qyteteve që kanë vizituar në Mal të Zi. I shkruajnë në tabelë. U kërkon të flasim diçka për secilin prej tyre.
- kërkon të shihen fotografitë e tre qyteteve në Librin e nxënësit, fq. 33;
- bën pyetjen: *Çfarë janë Ulqini, Podgorica dhe Tuzi?;*
- nxjerrin përfundimin, se *Ulqini, Podgorica, Tuzi* janë qytete, se fjala *qytet* është emërtimi i përbashkët për të tri qytetet dhe se *qytet* është emër i përgjithshëm;
- bën pyetjen: *Si quhet secili prej këtyre tri qyteteve?*
- nxjerrin përfundimet, se *Ulqin, Podgoricë, Tuz* janë emrat e veçantë të secilit prej tyre dhe se *Ulqin, Podgoricë, Tuz* janë emra të përveçëm;
- kërkon të shihet figura që paraqet fëmijët duke luajtur futboll, Libri i nxënësit fq. 33;
- bën pyetjet: *Çfarë janë ata që po luajnë? Si quhet secili prej tyre? I shkruan emrat e tyre në tabelë dhe vijon pyetjet: Çfarë tregon emri djalë dhe çfarë emri është? Çfarë tregojnë emrat Bardh, Angjelin, Pjetër dhe Arbër dhe çfarë emrash janë?;*
- nxjerrin përfundimet, se emri *djalë* që tregon të gjithë djemtë është emër i përgjithshëm, se emrat *Bardh, Angjelin, Pjetër* dhe *Arbër* që tregojnë djem të veçantë, janë emra të përveçëm.
- u kërkon të zhvillojnë ushtrimet 4-5 në Fletoren e punës, fq. 31. organizon verifikimin dhe korrigjimin e ushtrimeve.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Tregim sipas figurave

---

---

**Synimi:** të aftësohen për të folur, për të menduar në mënyrë logjike, për të gjykuar për veprimet e veta dhe të tjerëve dhe për të krijuar tekste me gojë dhe me shkrim.

### Ora e parë

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- pyet ku luajnë zakonisht dhe, nëse u ka ndodhur të shqetësojnë të tjerët me lojërat e tyre dhe si kanë vepruar në këto raste, a kanë kërkuar falje, në qoftë se po, si kanë vepruar;
- ndonjëri që dëshiron, mund të tregojë edhe ndonjë ngjarje konkrete që lidhet me këtë aspekt të jetës së tyre e që mund t'u kenë ndodhur atij ose shokëve të tij;
- thotë të shihen figurat në Librin e nxënësit, fq. 34;
- kërkon nga nxënësit t'u vënë emrat fëmijëve dhe të shpjegojnë veprimet e tyre sipas çdo figure;
- kërkon të vazhdojnë të imagjinojnë, se çfarë mund të ketë ndodhur, pasi kanë trokitur në derën e fqinjtit/ës, çfarë mund t'i kenë thënë atij dhe si mund t'u jetë përgjigjur ai;
- pranohen të gjitha shpjegimet e mundshme, mjafton që të jenë logjike dhe gjuhësisht korrekte.

### Ora e dytë

**Synimi:** të aftësohen për të menduar e shkruar në mënyrë logjike

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- kërkon të shkruhet në Fletoren e punës një tekst mbi bazën e figurave të dhëna në Librin e nxënësit, fq. 34 dhe t'i vënë një titull këtij teksti.  
pas 20- 25 minutash, kërkon nga disa nxënës që ta lexojnë shkrimin e tyre.
- kërkon nga nxënësit e tjerë që të bëjnë vlerësimin e saktësisë së interpretimit të figurave nga shokët e tyre dhe të titullit të zgjedhur prej tyre;
- teksti minimal do të mund të ishte: *Disa fëmijë po luanin futboll. Pa dashur thyen xhamin e fqinjtit. Fëmijët të shqetësuar shkuan t'i kërkojnë falje fqinjtit...*

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Si shkruhen emrat e përveçëm?

---

---

**Synimi:** të dallojnë emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm dhe t'i shkruajnë drejt ata.  
**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- kërkon të shihet tabela me emra të përgjithshëm dhe të përveçëm të shkruara sipas modelit në Librin e nxënësit, fq. 35;
- bën pyetjet: *Çfarë tregojnë emrat e grupit të parë? Çfarë tregojnë emrat e grupit të dytë? Çfarë emrash janë ato të grupit të parë? Çfarë emrash janë ato të grupit të dytë?*
- nxjerrin përfundimin, se emrat *djalë, qytet, qen* etj. janë emra të përgjithshëm, se emrat *Arben, Ulqin, Lupi* etj. janë emra të përveçëm;
- bën pyetjen: *Çfarë shkronje kanë në fillim emrat e përveçëm?*;
- nxjerrin përfundimin, se emrat e përveçëm shkruhen me shkronjë të madhe në fillim; u kujton rregullën që kanë mësuar në klasë të dytë se emrat e njerëzve, qyteteve, fshatrave dhe shkollave shkruhen me shkronjë të madhe në fillim;
- kërkon të zhvillohen ushtrimet 1- 7 në Fletoren e punës, fq. 33-35.

**Shënim:** nëse mësues-i/ja e sheh të nevojshme, mund të përdorë edhe një orë tjetër mësimi për këtë temë, duke pasur parasysh numrin dhe karakterin e ushtrimeve 1-7 në Fletoren e punës.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Në kalanë e Ulqinit

---

---

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të folurit dhe për të lexuar e kuptuar tekste të shkruara; të dallojnë emrat e përgjithshëm dhe të përveçëm, të shkruajnë me shkronjë të madhe emrat e përveçëm.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- bën pyetjen: *A keni qenë në qytetin e Ulqinit? Çfarë dini për këtë qytet? Po për kalanë e këtij qyteti, çfarë dini?*
- u thotë të lexojnë tekstin “Në kalanë e Ulqinit” në Librin e nxënësit, fq 36;
- bën pyetjet: *Çfarë vendosën të bënin nxënësit? Ku ndodhet kalaja e Ulqinit? Kur u nisën? Çfarë panë rrugës? Çfarë shihej nga kalaja?;*
- kërkon të gjejnë emrat me shkronjë të madhe në fillim dhe t’i shkruajnë në tabelë.
- bën pyetjen : *Pse këto emra shkruhen me shkronjë të madhe;*
- nxjerrin përfundimin, se emrat e përveçëm shkruhen me shkronjë të madhe në fillim.

**Shënim:** në dy orët në vazhdim, me të njëjtën procedurë do të vijojë analiza e teksteve “Qytetet tona” dhe “Vendlindja ime”. Nxënësit/et do t’u përgjigjen pyetjeve të parashtruara poshtë secilit tekst.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Fjalë që tregojnë cilësi

---

---

**Synimi:** të aftësohen për të lexuar dhe kuptuar tekste të shkruara joletrare, si edhe të dallojnë fjalët që shënojnë cilësi të sendeve, qenieve dhe dukurive, pra, mbiemrat.

### Ora e parë

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- pyet se cilat janë frutat e tyre të preferuara dhe kërkon të thonë pse u pëlqejnë;
- kërkon të lexohen me zë në Librin e nxënësit, fq. 39 tekstet që kanë shkruar Beni dhe Ada, përkatësisht, për portokallin dhe mollën;
- bën pyetjet: *Çfarë përshkruan Beni? Çfarë përshkruan Ada? Nga cili përshkrim keni mësuar më shumë? Pse?*;
- vijon me pyetjet: *Cilat fjalë tregojnë si është portokalli? Cilat fjalë tregojnë si është molla?*
- kërkon nga nxënësit/et që fjalët, të cilat përcaktojnë veçoritë e portokallit dhe të mollës, t'i shkruajnë në tabelë rreth figurës së portokallit dhe mollës, të vizatuara ose të vendosura në tabelë;
- nxjerrin përfundimin, se fjalët *i verdhë, i ëmbël* tregojnë cilësi të portokallit, kurse fjalët *i rrumbullakët, i kuq, i lëmuar, i vogël, i artë, i dobishëm, i madh, i bukur, i shijshëm, i shtrembër* tregojnë cilësi të mollës;
- kërkon të lexohen tekstet për qenin e Jakut dhe të Dritanit;
- bën pyetjet: *Çfarë përshkruan Jaku? Çfarë përshkruan Dritani? Cilat fjalë tregojnë si është qeni i Jakut? Cilat fjalë tregojnë si është qeni i Dritanit?*
- kërkon nga nxënësit/et, që fjalët të cilat përcaktojnë veçoritë e dy qenve, t'i shkruajnë në tabelë rreth figurës së qenit dhe mollës, të vizatuara ose të vendosura në tabelë;
- nxjerrin përfundimin, se fjalët *i bukur, i shpejtë, i mirë* tregojnë se si është qeni i Jakut, pra, cilësi të tij, se fjalët: *i bardhë, i pastër, i gjatë* tregojnë si është qeni i Dritanit, pra cilësi të tij.

### Ora e dytë

**Synimi:** të përforcojnë njohuritë për fjalët që tregojnë cilësi të sendeve, qenieve dhe dukurive.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- kërkon të lexohet teksti “*Të drejtat e lapsave*” në Librin e nxënësit, fq 40;
- bën pyetjet: *Çfarë kishin hedhur fëmijët në dysheme? Çfarë tha mësuesja kur i pa? Cilat fjalë tregojnë si janë lapsat, gomat, letrat? Çfarë janë fjalët të thyera, të pista, të grisura?*;
- nxjerrin përfundimin, se fjalët *të thyera, të pista, të grisura* që tregojnë si janë lapsat, gomat, letrat, janë mbiemra;
- kërkon të zhvillohen ushtrimet 1 -8 në Fletoren e punës, fq. 36-38.
- bëhet verifikimi dhe vlerësimi i realizimit të ushtrimeve që mësuesi i gjykon të arsyeshme.

**Shënim:** nëse mësues-i/ja e sheh të nevojshme, mund të përdorë edhe një orë tjetër mësimi për këtë temë, duke pasur parasysh numrin dhe karakterin e ushtrimeve 1-8 në Fletoren e punës.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Si të përshkruajmë?

**Synimi:** të aftësohen për të lexuar dhe kuptuar tekste të shkruara joletrare, si edhe për të përshkruar me gojë njerëzit, kafshët, sendet.

### Ora e parë

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- kërkon nga nxënësit të flasin për një shokun ose shoqen e tyre, të thonë: si është, si e ka trupin, si i ka flokët, si i ka sytë etj, si shkon me mësim, si vishet etj. fton të lexohet në Librin e nxënësit, fq. 41 teksti ku Genci përshkruan Bertin, shokun e tij;
- bën pyetjet: *Si është Berti? Si e ka fytyrën? Si i ka flokët? Si i ka sytë? Si e ka hundën? Ku banon? Si shkon me mësim? Si vishet?*
- nxjerrin përfundimin, se në përshkrimin e një njeriu duhet të fillojmë me përshkrimin e pamjes se jashtme, duke filluar nga koka e deri te këmbët, si vishet, ku banon, me çfarë merret etj. Këto mund t'i shkruhen në tabelë;
- kërkon që secili të zgjedhë një nga njerëzit e tij më të dashur dhe të mendojë, si do ta përshkruajë, duke u nisur nga përfundimet e mësipërme;
- bisedon me secilin nxënës/ëse dhe u ndihmon, nëse është e nevojshme;
- u thotë të përshkruajnë në Fletoren e punës, njeriun që kanë zgjedhur, duke pasur parasysh kërkesat e parashtruara në ushtrimin 1 fq. 39.

### Ora e dytë

**Synimi:** të aftësohen për të përshkruar me shkrim kafshët.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- kërkon nga nxënësit të përshkruajnë macen: si e ka trupin, si e ka lëkurën, si e ka kokën, si i ka këmbët, me se ushqehet etj.;
- fton të lexohet teksti “*Maçoku i Emit*” në Librin e nxënësit, fq. 42;
- bën pyetjet: *Si quhet maçoku i Emit? Çfarë moshe ka? Me cilën kafshë ngjan? Si është Riki? Kë do më shumë? Çfarë i pëlqen të hajë?*
- nxjerrin përfundimin, se në përshkrimin e një kafshe duhet filluar me pamjen e saj (trupi, lëkura, koka, këmbët), vendin ku jeton, ushqimin që ha, veprimet që bën, zërin që ka etj. Këto mësuesi mund t'i shkruajë në tabelë që t'i kenë parasysh nxënësit në punën e tyre të pavarur.
- kërkon që çdo nxënës të zgjedhë nga një kafshë shtëpiake dhe të mendojë si do ta përshkruajë, duke u nisur nga përfundimet e mësipërme;
- bisedon me secilin nxënës/ëse dhe u ndihmon, nëse është e nevojshme;
- thotë të përshkruajnë në Fletoren e punës kafshën që kanë zgjedhur, duke pasur parasysh
- kërkesat e parashtruara në ushtrimin 2, fq. 39.

**Shënim:** në orët në vazhdim nxënës-it/et do të lexojnë tekstet “*Flutura*” dhe “*Rruga ime për në shkollë*”, do t'u përgjigjen pyetjeve të shkruara poshtë secilit tekst dhe do të zhvillojnë ushtrimet 3-4 në Fletoren e punës. Mësuesi/ja do të ketë kujdes, që të vërë në dukje se në përshkrimin e objekteve, në këtë rast të shtëpisë, duhet filluar me pamjen e jashtme (forma, madhësia, ngjyra, materiali i përdorur për ndërtim, dritaret, dera, katet), pjesët përbërëse, hapësirat që ka, vendosja e tyre, funksioni, vendi ku ndodhet ndërtesa etj.



**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Fjalë që tregojnë veprime

**Synimi:** të aftësohen për të lexuar dhe kuptuar tekste të shkruara, si edhe për të dalluar fjalët që tregojnë veprime.

### Ora e parë

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- zhvillon bisedën për kukullat, pyet vajzat, nëse kanë kukulla, a u ka ndodhur ta humbasin dhe si ka ndodhur, nëse janë mërziur dhe a e kanë gjetur atë;
- fton nxënësit/et ta lexojnë së pari në heshtje dhe pastaj me zë tekstin “*Rudina është e trishtuar*” në Librin i nxënësit, fq. 45;
- pyet: *Si ndjeheni pasi e keni lexuar tekstin? A ju vjen keq për Rudinën?*
- thotë të lexohet vazhdimi i ngjarjes po aty dhe i pyet: *Si ndjeheni pas këtij përfundimi të gëzuar?*
- kërkon ta rilexojnë tekstin dhe të gjejnë fjalët që tregojnë, se çfarë bëri Rudina;
- nxjerrin përfundimin, se fjalët që tregojnë atë që ka bërë Rudina janë: *shkoj, dal, marr, mbledh, shoh, lë, vrapoj, lidh, ndez, kthehem, arrij, kujtohem, trishtohem, dua*;
- nxjerrin përfundimin, se fjalët: *shkoj, dal, marr, mbledh, shoh, lë, vrapoj, lidh, ndez, kthehem, arrij, kujtohem, trishtohem, dua* janë fjalë që tregojnë veprime;
- kërkon të zhvillohen ushtrimet 1-4 në Fletoren e punës, fq. 41.
- thotë të lexohen para klasës ushtrimet që mendon se është e nevojshme të verifikohen. Nxënësit bëjnë vërejtjet dhe vlerësimet e veta.

### Ora e dytë

**Synimi:** të aftësohen për të lexuar dhe kuptuar tekste të shkruara, si edhe për të dalluar fjalët që shënojnë veprime.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- bisedon për personazhin e letërsisë për fëmijë, miun “*Miki Maus*”. I pyet çfarë dinë për të, nëse kanë lexuar tekste që flasin për të, etj.;
- thotë, se do të mësojmë diçka më shumë për historinë e krijimit të këtij personazhi;
- kërkon të lexohet teksti “*Miki Maus*” në Librin e nxënësit, fq. 46;
- bën pyetjet: *Ku jetonte familja Diznei? Si quhej fëmija më i vogël dhe çfarë i pëlqente të bënte? Pse e dënoi babai? Çfarë e tërhiqnin në gazetatat që lexonte? Çfarë i rrinte pranë kur vizatonte? Si quhet miu që u bë i njohur në gjithë botën?;*
- kërkon të shihet tabela në vijim të tekstit dhe bën pyetjen: *Çfarë tregojnë fjalët vizatoj, lexoj, shes?;*
- nxjerrin përfundimin, se fjalët: *vizatoj, shes, lexoj* tregojnë veprime.

### Ora e tretë

**Synimi:** të aftësohen për të dalluar fjalët që tregojnë veprime ose foljet.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- bisedon me nxënësit për punët ose veprimtaritë që kryejnë ata. Shkruan në tabelë fjalët që tregojnë veprimet në shtëpi, në shkollë ose me shokët;
- kërkon të shihen figurat në Librin e nxënësit, fq. 47;
- bën, sipas radhës, për çdo figurë, pyetjet përkatëse: *Çfarë po bën vajza, nëna, piktori, djali, qeni, avioni? Çfarë po bëjnë fëmijët, patat?*
- nxjerrin përfundimin, se fjalët: *shkruan, gatuan, vizaton, ha, leh, fluturon, luajnë, notojnë*

janë fjalë që tregojnë veprime të njerëzve dhe kafshëve;

- kërkon të shihen figurat në vazhdim në Librin e nxënësit, fq. 47;
- bën për secilën nga figurat pyetjen: *Çfarë po ndodh në secilën nga figurat?*;
- nxjerrin përfundimin, se fjalët: *zbardh, fryn, vetëtin* janë fjalë që tregojnë veprime që ndodhin në natyrë, se fjalët që tregojnë veprime janë folje;
- kërkon të zhvillohen ushtrimet 5-7 në Fletoren e punës, fq. 42-43.

### Ora e katërt

**Synimi:** të aftësohen për të lexuar dhe kuptuar tekste të shkruara dhe të dallojnë fjalët që tregojnë veprime ose foljet.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- fton nxënësit /et ta lexojnë së pari në heshtje dhe pastaj me zë tekstin “ *Dy shokët* “ në Librin i nxënësit, fq. 48;
- pyet: *Çfarë ishin duke bërë dy shokët? Çfarë doli papritmas? Çfarë bëri njëri nga dy shokët? Po tjetri si veprroi? Pse u largua ariu? Çfarë mësojmë nga ky tekst?*;
- kërkon të thonë, si janë ndjerë gjatë leximit të tekstit, sidomos në momentin kur ariu afrohet pranë djalit dhe i merr erë;
- kërkon të ritregohet teksti me fjalët e tyre;
- thotë t’ a titullojnë tekstin që treguan.

### Ora e pestë

**Synimi:** të aftësohen për të dalluar foljet.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- thotë të rilexohet teksti “ *Dy shokët* ” në Librin e nxënësit, fq. \_\_\_ dhe të gjenden fjalët që tregojnë veprime;
- thotë t’ i shkruajnë në tabelë fjalët që tregojnë veprime;
- pyet, se çfarë janë fjalët *ecnin, doli, iku, u ngjit, u fsheh* etj që tregojnë veprime;
- nxjerrin përfundimin, se fjalët *ecnin, doli, iku, u ngjit, u fsheh* etj që tregojnë veprime janë folje.
- kërkon të zhvillohen ushtrimet 8-11 në Fletoren e punës, fq. 45.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Kryefjala dhe kallëzuesi

---

---

### Ora e parë

**Synimi:** të dallojnë brenda fjalisë fjalët, të cilat shënojnë veprimin dhe fjalët që shënojnë atë që kryen veprimin, pra kryefjalën dhe kallëzuesin.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- fton nxënësit të lexojnë fjalinë “*Zamira luan me top.*”, të shkruar më parë në tabelë;
- bën pyetjet: *Kush e kryen veprimin në këtë fjali? Çfarë bën Zamira?* fq. 49;
- nxjerrin përfundimin, se emri *Zamira* që tregon atë që kryen veprimin është kryefjalë e fjalisë dhe se folja *luan* që tregon veprimin të cili e kryen *Zamira* është kallëzuesi i fjalisë;
- udhëzon nxënësit/et të lexojnë fjalinë “*Zamira luan.*” në Librin e nxënësit;
- bën pyetjet: *Kush e kryen veprimin? Çfarë është fjala Zamira që kryen veprimin? Çfarë bën Zamira? Çfarë është fjala doli që tregon veprimin që kryen Zamira? Sa pjesë ka kjo fjali? Çfarë fjalie është ?;*
- nxjerrin përfundimin, se fjalia “*Zamira luan.*”, ka kryefjalën dhe kallëzuesin dhe që fjalia që ka vetëm kryefjalën dhe kallëzuesin quhet fjali e thjeshtë;
- fton nxënësit të lexojnë në Librin e nxënësit, fq. 49 fjalinë “*Zamira luan me macen e saj.*”, të cilën e shkruan në tabelë;
- bën pyetjet: *Kush e kryen veprimin? Çfarë është emri Zamira që kryen veprimin? Çfarë bën Zamira? Çfarë është folja doli që tregon veprimin që kryen Zamira? Çfarë fjalësh të tjera ka kjo fjali përveç kryefjalës dhe kallëzuesit? Përse shërbejnë fjalët me macen e saj? Çfarë fjalie është kjo?;*
- nxjerrin përfundimin, se fjalia “*Zamira luan me macen e saj.*”, përveç kryefjalës dhe kallëzuesit, ka edhe fjalë të tjera të cilat tregojnë diçka më shumë për të dhe se fjalia që ka përveç kryefjalës e kallëzuesit edhe fjalë të tjera quhet fjali e zgjeruar.

### Ora e dytë

**Synimi:** të dallojnë brenda fjalisë fjalët që shënojnë veprimin dhe fjalët që shënojnë atë që kryen veprimin, pra kryefjalën dhe kallëzuesin..

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- udhëzon nxënësit/et që të vështrojnë figurat në Librin e nxënësit, fq. 50.
- kërkon të lexohen fjalitë poshtë figurave dhe të shkruhen në tabelë;
- pyet se kush e kryen veprimin në secilën fjali dhe çfarë veprimi kryhet; kryefjalët janë shënuar me ngjyrë të kuqe, kurse kallëzuesit me ngjyrë blu;
- nxjerrin përfundimin, se ata që kryejnë veprimin, mund të jenë një ose disa vetë dhe se një person ose disa persona, mund të kryejnë një ose disa veprime, pra, që kryefjalë mund të jenë një ose disa persona dhe që kallëzues mund të jenë një ose disa folje;
- kërkon të jepen shembuj fjalish të thjeshta dhe të zgjeruara, të cilat i shkruan dhe i analizon së bashku me nxënësit në tabelë;
- u kërkon të zhvillojnë ushtrimet 1-5 në Fletoren e punës dhe t’i korrigjojnë ato.

**Shënim:** puna me ushtrimet 1-5 në Fletoren e punës, fq. 46-47 mund të shtrihet edhe në dy orë mësimi, nëse mësuesi e gjykon të arsyeshme.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Dy pikat dhe presja

### Ora e parë

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të lexuar e kuptuar tekste të shkruara dhe të përdorin drejt shenjat e pikësimit, dy pikat dhe presjen.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- kërkon të lexohet me zë teksti “*Shokët e klasës*” në Librin e nxënësit, fq. 51;
- bën pyetjet: *Sa fëmijë ka në klasën e Dianës? Sa fëmijë kanë lindur në të njëjtën ditë? Si shkojnë fëmijët me njëri-tjetrin? Ku shkojnë të dielave, kur është koha e mirë? Pse i marrin biletat disa ditë përpara? Po ju si shkoni me shokët e klasës?*
- kërkon të shkruhen në tabelë, ashtu siç janë në tekst, fjalitë: *Vetëm tre prej tyre: Dritani, Adriatiku dhe Besniku kanë lindur në të njëjtën ditë. Ata marrin me vete lodra të ndryshme: topa, raketa, domino etj. Prindërit u japin me vete: ushqime, fruta, pije të ndryshme etj.*, ku bëhet numërimi i disa gjërave;
- bën pyetjet: *Çfarë bëjmë në secilën nga këto tri fjali? Cilat janë fjalët që numërohen? Çfarë shenjash pikësimit janë vënë para fjalëve që numërohen? Çfarë shenjash pikësimit janë vënë ndërmjet fjalëve që numërohen?*;
- nxjerrin përfundimin, se, zakonisht, para fjalëve që numërohen vihen dy pika dhe se ndërmjet fjalëve që numërohen vihet presje, se presja tregon një pushim të shkurtër në të folur, që ajo vendoset në mes të fjalëve që numërohen, që dy pikat tregojnë se pas tyre vazhdon numërimi;
- u kërkon të lexojnë dhe të analizojnë përdorimin e shenjave të pikësimit në fjalitë në vazhdim;
- nxjerrin përfundimin, se dy pikat vendosen detyrimisht, nëse theksohet ajo që numërohet, kurse, nëse nuk theksohet ajo që numërohet, atëherë, dy pikat mund të vihen ose jo;

### Ora e dytë

**Synimi:** të përdorin drejt shenjat e pikësimit, dy pikat dhe presjen.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- fton nxënësit/et të lexojnë në Librin e nxënësit, fq. 52 ose të shkruar më parë në tabelë në dy variante fjalinë “*Në dyqan, nëna bleu: mollë, patate, vaj ulliri dhe lëngje frutash.*”;
- bën pyetjen: *Pse është fshirë njëra nga këto dy fjali?*;
- nxirret përfundimi, pas diskutimit, për përdorimin e saktë ose të gabuar të shenjave të pikësimit, nxirret përfundimi se fjalia e parë është e saktë, kurse e dyta e gabuar, sepse mungojnë dy pikat;
- kërkon të zhvillohen ushtrimet 1-5 në Fletoren e punës, fq. 48-49;
- kërkon nga nxënësit, të paraqesin para klasës rezultatet e punës së vet dhe të bëjnë vlerësimin për ushtrimet që mësuesi/ja e gjykon të arsyeshme.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Tregim sipas figurave

---

---

**Synimi:** të aftësohen për të folur, për të menduar në mënyrë logjike, për të gjykuar për veprimet e veta dhe të tjerëve dhe për të krijuar tekste me gojë dhe me shkrim.

### Ora e parë

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- pyet nxënësit/et, nëse kanë dëgjuar ose lexuar tregime për kafshët, veçanërisht për dredhitë e dhelprës dhe nëse mund të tregojnë ndonjë prej tyre;
- thotë të shihen figurat në Librin e nxënësit, fq. 53;
- kërkon nga nxënësit të tregojnë përmbajtjen e secilës prej tyre;
- thotë të tregojnë përmbajtjen e tekstit në tërësi;

### Ora e dytë

**Synimi:** të aftësohen për të menduar e shkruar në mënyrë logjike.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- u kërkon të shkruajnë në Fletoren e punës, fq. 50 një tekst mbi bazën e figurave të dhëna në Librin e nxënësit, fq. 53, si edhe ta titullojnë tekstin të krijuar prej tyre;
- pas 20- 25 minutash u kërkon disa nxënësve të lexojnë atë që kanë shkruar;
- kërkon nga nxënësit e tjerë, të bëjnë vlerësimin e saktësisë së interpretimit të figurave nga shokët e tyre dhe të titullit që kanë zgjedhur.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**







## Toka rrotullohet

---

---

### Ora e parë

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të lexuar, analizuar e kuptuar tekste të shkruara joletrare në përshtatje me moshën e tyre.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- fton nxënësit të flasin për Tokën mbi bazën e atyre që kanë mësuar në klasë të dytë. Në klasë të dytë, ata kanë analizuar tekstin “*Toka është e rrumbullakët*” dhe kanë provuar përmes një eksperimenti të thjeshtë, sesi formohet dita dhe nata. Ja disa nga pyetjet që mund të bëhen: *Si është Toka? Ku ndryshon ajo nga Dielli dhe Hëna? A e dini si formohet dita dhe nata në Tokë?*;
- u thotë, se do të mësojnë diçka më shumë për Tokën dhe u kërkon të lexojnë tekstin në Librin e nxënësit, fq. 56;
- u kërkon të thonë fjalët që nuk i kuptojnë;
- bashkëbisedon për kuptimin e fjalëve të vështira;
- bën pyetjet: *Si është Toka? Për ç’arsye diku është ditë dhe diku natë? Si formohen stinët e ndryshme? Me se është e mbështjellë? Përse shërben Dielli? Përse nuk duhet ta shohim Diellin drejtpërdrejt?*
- u kërkon të bëjnë ushtrimet 1-3 në Fletoren e punës, fq. 52.

### Ora e dytë

**Synimi:** të dallojnë paragrafët në një tekst dhe të përforcojnë njohuritë e fituara për Tokën përmes një eksperimenti të thjeshtë.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- u kërkon ta rilexojnë tekstin “*Toka rrotullohet*”;
- bën pyetjet: *Sa pjesë ka në tekst? Për çfarë flitet në pjesën e parë? Për çfarë flitet në pjesën e dytë? Si quhen pjesët e një teksti?*;
- nxirret përfundimi, se çdo pjesë e një teksti është një paragraf dhe se ky tekst ka dy pjesë ose dy paragrafë;
- kërkon të bëjnë eksperimentin e kërkuar në Librin e nxënësit, fq. 57;
- nxirret përfundimi, se dita dhe nata janë rezultat i rrotullimit të Tokës rreth vetes për njëzet e katër orë?
- jep detyrë, të gjejnë në enciklopedi dhe burime të tjera të dhëna për tokën dhe t’i shkruajnë në fletoren e detyrave.

**Shënim:** ndjek të njëjtën procedurë edhe për mësimin “*Edhe Hëna rrotullohet.*”

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Emrat kanë gjini dhe numër

### Ora e parë

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të dalluar emrat dhe për të gjetur gjininë dhe numrin e tyre.  
**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- shkruan në tabelë fjalitë: *Dielli i jep Tokës dritën e ngrohtësinë. Toka rrotullohet rreth diellit.*, ashtu siç paraqiten në Librin e nxënësit, fq. 58;
- pyet çfarë fjalish janë dhe kërkon të gjejnë: kryefjalën, kallëzuesin, fjalët plotësuese. Vazhdon me pyetjet: *Me se mbaron emri Diell në fjalinë e parë? Me se mbaron emri Tokë në fjalinë e dytë?*;
- nxirret përfundimi, emri *Diell-i* që mbaron me – *i* është i gjinisë mashkullore, se emri *Toka* që mbaron me – *a* është i gjinisë femërore;
- fton të shihet tabela që vijon në Librin e nxënësit, fq. 58-59;

Gjinia mashkullore	Gjinia femërore
babai	nëna
djali	vajza
vëllai	motra
miku	rrezja
shoku	gruaja
zogu	
krahu	

- bën pyetjet: *Me se mbarojnë emrat e kolonës së parë? Në çfarë gjinie janë emrat e kolonës së parë? Me se mbarojnë emrat e kolonës së dytë? Në çfarë gjinie janë emrat e kolonës së dytë?*;
- nxirret përfundimi se emrat janë në gjininë mashkullore dhe në gjininë femërore, që emrat që mbarojnë me –*i*, –*u* janë në gjininë mashkullore, kurse ata që mbarojnë me –*a*, –*ja* janë në gjininë femërore.

### Ora e dytë

**Synimi :** të përforcojnë aftësinë për të dalluar emrat dhe për të përcaktuar gjininë e tyre.  
**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- kërkon të zhvillohen ushtrimet 1-4 në Fletoren e punës, fq. 54-55;
- kërkon të paraqiten rezultatet e punës së kryer;
- organizon korrigjimin e tyre.

**Shënim:** ndjek të njëjtën procedurë edhe për pjesën në vazhdim kushtuar *Numrit të emrave*. Mësimi mbyllet me ushtrimet 5-9 në Fletoren e punës, fq. 55-56.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Mbiemrat kanë gjininë dhe numrin e emrave

### Ora e parë

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të dalluar mbiemrat dhe për të përcaktuar gjininë dhe numrin e tyre.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- fton të flasin për stinën e dimrit dhe të verës, i pyet si është dimri dhe vera në krahinën e tyre, nëse bën ftohtë në dimër dhe nxehtë në verë dhe si veprojnë ata në këto raste;
- shkruan në tabelë fjalinë: *Tek ne bën dimër i ftohtë dhe verë e nxehtë.*, ashtu siç paraqiten në Librin e nxënësit, fq. 60;
- bën pyetjet: *Cilat fjalë plotësojnë mbiemrat i ftohtë dhe e nxehtë? Në çfarë gjinie është emri dimër? Në çfarë gjinie është emri verë? Në çfarë gjinie janë mbiemrat i ftohtë dhe e nxehtë?*;
- nxirret përfundimi se emri *dimër-i* është në gjininë mashkullore dhe se, për pasojë, edhe mbiemri *i ftohtë*, që lidhet me të, është në gjininë mashkullore; se emri *verë-a* është në gjininë femërore dhe se, për pasojë, edhe mbiemri *e nxehtë*, që lidhet me të, është në gjininë femërore;
- fton të shihet tabela që vijon në Librin e nxënësit, fq. 61;

Gjinia mashkullore		Gjinia femërore	
(një) djalë	<i>i vogël</i>	(një) vajzë	<i>e vogël</i>
(një) vëlla	<i>i madh</i>	(një) motër	<i>e madhe</i>
(një) nxënës	<i>i sjellshëm</i>	(një) nxënëse	<i>e sjellshme</i>
(një) shok	<i>i mirë</i>	(një) shoqe	<i>e mirë</i>

- bën pyetjet: *Në çfarë gjinie janë emrat e kolonës së parë? Pse? Në çfarë gjinie janë mbiemrat e kolonës së dytë? Pse?*;
- nxirret përfundimi, se mbiemrat kanë të njëjtën gjini që kanë emrat me të cilët lidhen.

### Ora e dytë

**Synimi:** të përforcojnë aftësinë për të dalluar mbiemrat dhe për të gjetur gjininë e tyre.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- thotë të zhvillojnë ushtrimet 1-6 në Fletoren e punës, fq. 57-58;
- u kërkon të paraqiten rezultatet e punës së bërë me ushtrimet;
- organizon verifikimin, diskutimin dhe korrigjimin e atyre ushtrimeve që e gjykon të arsyeshme.

**Shënim:** ndjek të njëjtën procedurë edhe për pjesën tjetër të mësimit kushtuar *Numrit të mbiemrave*. Mësimi mbyllet me ushtrimet 7-11 në Fletoren e punës, fq. 59-60.

**Vërejtjet e mësues-it/es:**

## Dhëmbët tanë

---

---

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të lexuar me zë dhe në heshtje, për të analizuar dhe kuptuar tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tyre.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- zhvillon me nxënësit një bisedë të lirë për dhëmbët. Pyet, përse shërbejnë dhe çfarë dinë ato për dhëmbët, si janë, sa janë, kur dalin etj.
- thotë, se do të mësojnë diçka më shumë për dhëmbët dhe kërkon të hapin Librin e nxënësit, fq. 62;
- pyet, sa paragrafë ka teksti *Dhëmbët tanë* dhe kërkon të lexohet në heshtje paragrafi i parë dhe pas mbarimit të leximit, pyet: *Sa herë dalin dhëmbët dhe si quhen ata? Sa dhëmbë qumështi ka njeriu? Kur dalin e kur bien dhëmbët e qumështit?*
- kërkon të lexohet në heshtje paragrafi i dytë dhe pyet: *Kur bien dhëmbët e qumështit dhe zëvendësohen me dhëmbët e përhershëm? Sa dhëmbë të përhershëm ka njeriu? Cilat janë pjesët përbërëse të dhëmbit?*
- kërkon të lexohet në heshtje paragrafi i tretë dhe pyet: *Përse shërbejnë dhëmbët? Si duhet t'i mbajmë dhëmbët? Pse duhet të kujdesemi për dhëmbët?*
- thotë të lexohet edhe një herë teksti i plotë dhe kërkon pastaj të flasim për dhëmbët e tyre, të thonë sa dhe ç'dhëmbë kanë, sa dhe cilët dhëmbë u kanë rënë.
- kërkon zhvillimin në mënyrë të pavarur të ushtrimeve 1-3 në Fletoren e punës, fq. 61;

**Shënim:** ndjek të njëjtën procedurë për pjesën në vazhdim “*Pse na prishen dhëmbët.*”

Organizon një vizitë në klinikën dentare. I ndan nxënësit në grupe dhe u jep detyrë të grumbullojnë të dhëna:

Grupi i parë: Si është klinika dentare? Çfarë ka në klinikën dentare? Kush punon në klinikën dentare?

Grupi i dytë: Cilat janë sëmundjet më të shpeshta të dhëmbëve?

Grupi i tretë: Si rregullohen dhëmbët?

Grupi i katërt: Cili ushqim është i keq për dhëmbët?

Grupi i dytë, i tretë dhe i katërt duhet t'i kërkojë të dhënat tek personeli i klinikës dentare.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Fjalë që zëvendësojnë emrat

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të dalluar përemrat vetorë në njëjës dhe në shumës.  
**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- u thotë të lexojnë me zë tekstin “*Nora nuk kujdeset për dhëmbët e saj*” në Librin e nxënësit, fq. 64;
- bën pyetjet: *Cilën fjalë zëvendëson fjala ajo? Po ai? Cilën fjalë zëvendëson fjala ato? Po ata? Çfarë janë fjalët ajo, ai, ato, ata që zëvendësojnë emrat Nora, dentisti, ëmbëlsira, dhëmbët?*;
- nxirret përfundimi, se fjalët *ai, ajo, ata ato*, që zëvendësojnë emrat, janë përemra vetorë;
- fton të shihet tabela e përemrave vetorë në Librin e nxënësit, fq. 64, të cilën mund ta shkruajë edhe në tabelë;

Numri njëjës	Numri shumës
unë	ne
ti	ju
ai, ajo	ata, ato

- bën pyetjet: *Sa përemra vetorë ka gjuha shqipe? Cilët janë përemrat vetorë të numrit njëjës? Cilët janë përemrat vetorë të numrit shumës?*;
- nxirret përfundimi, se në gjuhën shqipe, përemrat vetorë në numrin njëjës janë: *unë, ti ai/ajo* dhe përemrat vetorë në numrin shumës: *ne, ju, ata/ato*.
- kërkon të zhvillohen ushtrimet 1-3 në Fletoren e punës, fq. 62.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Tek ne rriten shumë zarzavate

---

---

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të lexuar me zë dhe në heshtje, për të analizuar e kuptuar dhe tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tyre.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- zhvillon bisedë për llojet e ndryshme të zarzavateve që rriten në zonën ku ata banojnë dhe ndalet më konkretisht tek bima e domates; kërkon të thonë, se çfarë dinë për bimën e domates, si mbillet, ku mbillet, si i ka frytet etj;
- kërkon të shihet ilustrimi në Librin e nxënësit, fq. 65 dhe të lexojnë në heshtje tekstin “Domatja”;
- shpjegon fjalët e panjohura ose pak të njohura;
- bën pyetjet: *Nga e ka origjinën domatja? Sa kohë duhet që të bëhen domatet? Si i kanë lulet? Si janë domatet (madhësia, ngjyra shija, farat)? Si janë domatet që rriten tek ju?*;
- kërkon të shkruhen të rejat që janë mësuar nga ky tekst për domaten;
- kërkon të zhvillohen ushtrimet 1-3 në Fletoren e punës, fq. 63.
- kërkon të lexohet çfarë kanë shkruar nxënësit në ushtrimin nr.2 për përgatitjen e sallatës dhe bën vlerësimin e tyre;
- paraqiten vizatimet e bëra mbi bazën e kërkesës së ushtrimit nr. 3 dhe bëhet vlerësimi i tyre.

**Shënim:** ndjek të njëjtën procedurë edhe për “Specin”.

Për tematikën lidhur me zarzavatat, mund të organizohet edhe një orë e veçantë, ku të flitet për gjellët që përgatiten me domate dhe specat.

Për këtë, nxënësit pyeten, se çfarë gjellësh përgatitin në familjen tyre me domate ose me specat. Jepet detyrë të shkruajnë në shtëpi me ndihmën e prindërve e ose të librave të kuzhinës etj. recetën e ndonjë gjelle që përgatitet me këto zarzavate dhe organizon orën e mësimit mbi këtë bazë.

Mund t’u kërkojë nxënësve, të sjellin me vete zarzavate të caktuara dhe të përgatitin me to në klasë një sallatë me specat dhe domate.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Dje, sot, nesër

**Synimi :** të zhvillojnë aftësinë për të dalluar tri kohët themelore të foljeve, të tashmen, të shkuarën dhe të ardhmen.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- shkruan në tabelë fjalitë: *Dje Teuta mbolli domate. Sot Teuta mbjell bamje. Nesër Teuta do të mbjellë qepë.*, ashtu siç paraqiten në Librin e nxënësit, fq. 67;
- pyet, çfarë fjalish janë dhe kërkon të gjejnë; kryefjalën, kallëzuesin, fjalët plotësuese.
- vijon me pyetjet: *Kur kryhet veprimi në fjalinë e parë? Kur kryhet veprimi në fjalinë e dytë? Kur kryhet veprimi në fjalinë e tretë? Si e kuptoni?*  
nxirret përfundimi, se veprimi i fjalisë së parë kryhet në kohën e shkuar, se veprimi i fjalisë së dytë kryhet në kohën e tashme, kurse veprimi i fjalisë së tretë, kryhet në kohën e shkuar;
- fton të shihet tabela në vijim në Librin e nxënësit, fq. \_\_\_\_, të cilën mund ta shkruajë edhe në tabelë;

Koha e shkuar dje	Koha e tashme sot	Koha e ardhme nesër
Hëngra bukë.	Po ha bukë	Do të ha bukë
Piva ujë.	Po pi ujë	Do të pi ujë.
Laga domatet.	Po lag bamjet.	Do të lag qepët.

- bën pyetjet: *Kur kryhet veprimi në fjalitë e kolonës së parë? Kur kryhet veprimi në fjalitë e kolonës së dytë? Kur kryhet veprimi në fjalitë e kolonës së tretë? Çfarë ndryshon në fjalitë e tri kolonave?*
- nxirret përfundimi, se në një fjali veprimet mund të kryhen: në kohën e shkuar (dje), në kohën e tashme (sot) ose në kohën e ardhme (nesër); se foljet kanë tri kohë: të shkuarën, të tashmen dhe të ardhmen: *hëngra (koha e shkuar), ha (koha e tashme), do të ha (koha e ardhme)*
- kërkon të zhvillohen ushtrimet 1-5 në Fletoren e punës, fq. 64.
- kërkon të paraqitet puna e bërë dhe të bëhet vlerësimi i saj.

**Shënim:** ndjek të njëjtën procedurë edhe për mësimin “*Foljet ndryshojnë.*” Mësimi mbyllet me ushtrimet 1-4 në Fletoren e punës, fq. 65 .

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**



## Tek ne ka shumë fruta

---

---

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të lexuar me zë dhe në heshtje, për të analizuar kuptuar dhe tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tyre.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- zhvillon bisedë për llojet e ndryshme të frutave që rriten në Mal të Zi dhe konkretisht në zonën ku ata banojnë, duke u ndalur më konkretisht tek molla; kërkon të thonë çfarë dinë për bimën dhe frutën e mollës;
- kërkon të shohin ilustrimin në Librin e nxënësit, fq. 69 dhe të lexojnë në heshtje tekstin “Molla”;
- shpjegon fjalët e panjohura ose pak të njohura;
- bën pyetjet për bimën e mollës: *Si e ka trupin? Si i ka gjethet? Si i ka lulet? Vazhdon me pyetje për frutën e mollës :Si e ka formën? Si e ka ngjyrën? Çfarë madhësie ka? Si e ka shijen?* U kërkon të përshkruajnë mollët që rriten tek ata;
- kërkon të shënojnë se ç’gjëra të reja kanë mësuar nga ky tekst për mollën;
- kërkon të zhvillojnë ushtrimet 1-4 në Fletoren e punës, fq. 66.

**Shënim:** për tematikën lidhur me frutat mund të organizohet edhe një orë e veçantë, ku të flitet për një frutë tjetër ose për ëmbëlsirat që përgatiten me mollë ose fruta të tjera.

Për këtë, nxënësit pyeten, se çfarë ëmbëlsirash përgatitin në familjen tyre me mollë ose fruta të tjera.

Jepet detyrë të shkruajnë në shtëpi, me ndihmën e prindërve ose të librave të kuzhinës etj., recetën e ndonjë ëmbëlsire që përgatitet me fruta dhe organizon orën e mësimit mbi këtë bazë.

Kërkon nga nxënësit të sjellin me vete fruta të caktuara. Kërkon që të përgatitin në klasë një sallatë frutash ose një ëmbëlsirë tjetër që mësuesi e gjykon të arsyeshme.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Pjesët plotësuese të fjalisë

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të dalluar pjesët plotësuese të fjalisë.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- shkruan në tabelë fjalitë: *Zana bleu mollë. Vëllai bleu fiq. Nëna bleu tortë.* ashtu siç paraqiten në Librin e nxënësit, fq. 70;
- pyet se çfarë fjalish janë dhe kërkon nga nxënësit të gjejnë kryefjalën, kallëzuesin;
- vijon me pyetjet: *Me cilat fjalë lidhen fjalët mollë, fiq, tortë? Përse shërbejnë fjalët mollë, fiq, tortë? Çfarë janë fjalët mollë, fiq, tortë?;*
- nxirret përfundimi, se fjalët *mollë, fiq, tortë* plotësojnë kuptimin e foljes *bleu*, se fjalët *mollë, fiq, tortë* që plotësojnë kuptimin e foljes *bleu* janë pjesë plotësuese të fjalisë;
- fton të shihet tabela në vijim në Librin e nxënësit. fq. 70, të cilën mund ta shkruajë edhe në tabelë;

Kryefjala	kallëzuesi (folja)	pjesa plotësuese
Blerta	hëngri	fiq.
Roberti	bleu	mollë.
Ne	volëm	rrush.

- bën pyetjet: Çfarë tregojnë fjalët *Blerta, Roberti, ne* në këto fjali? Çfarë janë fjalët *Blerta, Roberti, ne*, që tregojnë atë që e kryen veprimin në fjali? Çfarë tregojnë fjalët *hëngri, bleu, volëm* në këto fjali? Çfarë janë fjalët *hëngri, bleu, volëm*, që tregojnë çfarë bëjnë *Blerta...* në fjali?; *Cilat fjalë plotësojnë fjalët: fiq, mollë, rrush? Çfarë janë fjalët: fiq, mollë, rrush, që plotësojnë kuptimin e foljeve?;*
- nxirret përfundimi se fjalët që shërbejnë për të plotësuar kuptimin e foljes në fjali janë pjesë plotësuese të fjalisë;
- kërkon të zhvillohen ushtrimet 1-5 në Fletoren e punës, fq. 68;
- kërkon të paraqitet puna e bërë dhe të bëhet vlerësimi i punës.

**Vërejtjet e mësues-it/es:**

## Tek ne ka shumë lloje peshqish

---

---

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të lexuar me zë dhe në heshtje, për të analizuar e kuptuar tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tyre dhe të krijojnë vetë tekste të tilla.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- zhvillon një bisedë për llojet e ndryshme të peshqve dhe ndalen më konkretisht tek krapin;
- u kërkon të thonë çfarë dinë për krapin, ku rritet, si është, sa i madh është etj.;
- kërkon të shohin Librin e nxënësit, fq. 71 dhe të lexojnë në heshtje tekstin “Krapin”;
- shpjegon fjalët e panjohura ose pak të njohura;
- bën pyetjet: *Ç’janë peshqit? Ku gjendet krapin? Si është krapin? Sa është i gjatë? Sa peshon? Si ushqehet? Si e ka mishin? Kur shtohet? Kur peshkohet krapin?;*
- kërkon të shkruhen të rejtat që kanë mësuar nga teksti për krapin;
- fton të lexojnë në Librin e nxënësit, fq. \_\_, tekstin “*Liçeni i Shkodrës*” dhe të diskutojnë për përmbajtjen e tij.
- kërkon të zhvillojnë ushtrimet 1-3 në Fletoren e punës, fq. 69.

**Shënim:** ndjek të njëjtën procedurë edhe për tekstin “*Qefulli*”.

Për tematikën lidhur me peshqit, mund të organizohet edhe një orë e veçantë, ku të flitet për akuariumin. Për këtë, nxënësit pyeten, nëse kanë akuarium, se ç’peshq kanë në akuarium, si kujdesen për ta etj.

Shihet mundësia e përgatitjes së një akuariumi nga vetë nxënësit me peshq me ngjyra.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Shqiponja

---

---

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të lexuar me zë dhe në heshtje, për të analizuar dhe për të kuptuar tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tyre dhe të krijojnë vetë tekste të tilla.  
**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- zhvillon bisedë për shpendët që njohin, duke u ndalur më konkretisht tek shqiponja;
- kërkon të thonë çfarë dinë për shqiponjën, si është, ku jeton, me se ushqehet etj. ;
- kërkon të shihet ilustrimi në Librin e nxënësit, fq 73 dhe të lexohet në heshtje teksti “*Shqiponja*”;
- shpjegon fjalët e panjohura ose pak të njohura;
- bën pyetjet: *Si është shqiponja? Ku jeton dhe ku e bën folenë? Me se ushqehet? Sa vjet jeton shqiponja?*;
- kërkon të shkruajnë të rejat që kanë mësuar nga tekst i *Shqiponja*.

### Ora e dytë

**Synimi :** të aftësohen të shkruajnë vetë tekste mbi subjekte të analizuar.  
**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- kërkon të zhvillohen ushtrimet 1 në Fletoren e punës, fq. 70;
- thotë të paraqiten rezultatet e punës dhe të bëhet përshkrimi i shqiponjës;
- organizon diskutimin dhe korigjimin e punimeve me shkrim.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Viti i Ri

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të lexuar me zë dhe në heshtje, për të analizuar dhe për të kuptuar tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tyre dhe të krijojnë vetë tekste të tilla. **Është e nevojshme :** një këngë për Vitin e Ri e regjistruar në magnetofon.

### Ora e parë

#### Veprimtaritë e mësues-it/es:

- zhvillon bisedë për festat, duke u ndalur më konkretisht tek festa e Viti të Ri; kërkon të thonë ç'dinë për këtë festë, kur bëhet, ku bëhet; si festohet etj.;
- thotë të dëgjojnë këngën e Vitit të Ri;
- bën pyetje për përmbajtjen e këngës;
- thotë, se do të mësojmë diçka më shumë për festën e Vitit të Ri;
- kërkon të shihet ilustrimi në Librin e nxënësit, fq. 74 dhe të lexohet në heshtje teksti “*Viti i Ri*”;
- shpjegon fjalët e panjohura dhe pak të njohura;
- bën pyetjet: *Çfarë besonin romakët e vjetër për ardhjen e Vitit të Ri? Si e festonin ata Vitin e Ri? Po ne, si e presim Vitin e Ri? Kush gëzohet më shumë? Ku e festojnë të rinjtë Vitin e Ri?*;
- vijon me pyetjet: *Sa paragrafë ka ky tekst? Përse flitet në secilin nga paragrafët e këtij teksti? Kërkon që të titullohet çdo paragraf;*
- kërkon të shkruhen të rejat që kanë mësuar nga teksti *Viti i Ri* në një tabelë si kjo :

KEMI DITUR	KEMI MËSUAR

### Ora e dytë

**Synimi :** të aftësohen të shkruajnë vetë tekste mbi subjekte të analizuar.

#### Veprimtaritë e mësues-it/es:

- u kërkon të zhvillojnë ushtrimet 1-4 në Fletoren e punës, fq. 71;
- thotë të paraqiten rezultatet e punës së kryer për ushtrimet 1 dhe 4.
- organizon diskutimin dhe korrigjimin e punimeve me shkrim.

#### Vërejtjet e mësues-it/-es:

## Dikur ishte fushë

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të lexuar me zë dhe në heshtje, për të analizuar dhe për të kuptuar tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tyre dhe të krijojnë vetë tekste të tilla.  
**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- pyet nxënësit, nëse kanë pasur rastin të vizitojnë liqenin e Shkodrës dhe kërkon të thonë, çfarë dinë për të, ku ndodhet, sa larg është nga vendbanimi i tyre, sa i madh është, për çfarë u ka pëlqyer më shumë etj.;
- thotë, se do të mësojnë diçka më shumë për këtë liqen;
- kërkon që në Librin e nxënësit, fq. 75 të lexojnë në heshtje tekstin “Dikur ishte fushë”;
- jep detyrë që për çdo paragraf të shkruajnë në fletore të reja për liqenin e Shkodrës;

KEMI DITUR	KEMI MËSUAR

- bën pyetjet: *Ku shtrihet liqeni i Shkodrës? Çfarë ka qenë aty në kohët e lashta? Si është liqeni i Shkodrës? Sa e ka thellësinë? Çfarë malesh e rrethojnë? Çfarë përrënsh e lumenjsh derdhen në liqen? Sa ishuj ka? Çfarë shpendësh ose bimësh të rralla gjenden në liqenin e Shkodrës?*
- jep detyrë të mbledhin të dhëna të tjera për liqenin e Shkodrës, fotografi, kartolina, të dhëna nga enciklopeditë ose Interneti me ndihmën edhe të prindërve.

### Ora e dytë

**Synimi:** të aftësohen të shkruajnë vetë tekste mbi subjekte të analizuar.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- kërkon të paraqesin fotografitë, kartolinat etj. që kanë mbledhur për liqenin e Shkodrës;
- thotë të lexojnë me zë para klasës se çfarë kanë shkruar në fletoret e tyre për liqenin e Shkodrës dhe të evidentojnë të dhënat e reja të sjella prej tyre;
- kërkon të ngjisin në Fletoren e punës, fq. 72 fotografitë që kanë gjetur dhe të shkruajnë në mënyrë të pavarur një tekst për Liqenin e Shkodrës duke shfrytëzuar tekstin bazë në Librin e nxënësit dhe ato që kanë grumbulluar vetë për këtë temë.
- për tematikën që lidhet me liqenin e Shkodrës mund të shihet mundësia e një ekskursioni në breg të liqenit. Ky do të ishte një rast më shumë për t’i konkretizuar e ngulitur njohuritë e fituara për këtë temë.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

## Veglat tona popullore

---

---

**Synimi:** të zhvillojnë aftësinë për të lexuar me zë dhe në heshtje, për të analizuar dhe për të kuptuar tekste joletrare të përshtatshme për moshën e tyre dhe të krijojnë vetë tekste të tilla. **Është e nevojshme:** lahuta, një melodi popullore luajtur me lahutë, e regjistruar në magnetofon.

**Veprimtaritë e mësues-it/es:**

- kërkon të dëgjojnë melodinë e regjistruar në magnetofon dhe të gjejnë çfarë vegle muzikore është;
- kërkon të thonë se çfarë dinë për lahutën, si është, çfarë këngësh këndohen më lahutë etj. dhe u tregon lahutën;
- pyet, a di ndonjëri t'i bie lahutës dhe po qe se ka, e fton t'i bjerë lahutës;
- thotë të lexojnë në heshtje në Librin e nxënësit, fq. 76 "*Lahuta me Skanderbeg*" dhe të vërejnë të dhënat kryesore për këtë vegël muzikore;
- sqaron fjalët e panjohura dhe më pak të njohura, nëse ka;
- bën pyetjet: *Çfarë është lahuta? Si është lahuta? Si e ka trupin? Si e ka kokën? Si është harku i lahutës? Si i bihet lahutës? Çfarë këndohet me lahutë?*
- porosinë nxënësit/et të vështrojnë dhe analizojnë dallimet dhe ngjashmëritë e lahutave në Librin e nxënësit, fq. 76;
- jep detyrë shtëpie që, në revistat për fëmijë ose në enciklopedi, të gjejnë të dhëna për veglën muzikore që u pëlqen dhe të shkruajnë për të.
- analizon hartimet në fillimin e orës së ardhshme ose, nëse e sheh të arsyeshme, organizon një orë mësimi të posaçme.

**Shënim:** ndjek të njëjtën procedurë edhe për mësimin "*Çiftelia me dy tela*", fq. 77.

Për tematikën lidhur me veglat muzikore mund të organizohet edhe një orë e veçantë, ku nxënësit ose mësuesi sjellin në klasë vegla muzikore popullore. Mësuesi/ja, kërkon të diskutojnë për ngjashmëritë dhe dallimet e tyre. Nëse është e mundur, në bashkëpunim mund të përpiqen të punojnë një vegël muzikore të thjeshtë.

**Vërejtjet e mësues-it/-es:**

# Zgjidhjet e ushtrimeve të Fletores së punës

## Ne flasim shqip, po Marina ...?

2. a) serbishtja; b) shqipja
3. Ulqin dhe rrethina; Tuz dhe rrethina; Në Krajë dhe rrethina.

## Në shtëpi dhe në shkollë

1. Mbrëmë kam fjetur vonë.; Sot jam ngritur herët.; Kam shkuar në shkollë me Dianën.
2. syri; këmba; fytyra; gjuri; shoh; vatra
3. E shoh çdo mëngjes kur shkoj në shkollë.  
Në verë shet fruta, në dimër gështenja të pjekura.  
Të gjithë fëmijët e lagjes e njohin.
4. Vajza : Ma dhe lapsin. Tani më thuaj, çfarë të vizatoj.  
Nëna : Vizato zogun.  
Vajza : Po tani?  
Nëna : Vizato macen dhe pastaj qengjin.

## Bisedojmë me njëri-tjetrin

1. Po flet Blerta.; Blerta po flet me Ermalin.; Blerta po flet mirë.
2. Ardi: Mësuese, më fal, po unë e kam harruar fletoren në shtëpi,  
Mësueja: Nuk ka gjë. Kujdes herën tjetër.

## Alo, mirëdita ...

1. Mrika.; Mrika flet me Gjystinën.; Mirëdita!; Gjystinën, ju lutem.; Urdhëro!
2. - **Mirëdita** . Shpresa jeni?  
- Po. Urdhëroni.  
- **Ju lutem**, a mund të më thoni, kur vjen Zana?  
- Të dielën, në orën 18<sup>00</sup> vjen avioni.  
- **Faleminderit**. Mirupafshim.
3. - **Mirëdita**.  
- Mirëdita.  
- Jam Gazmendi, shoku i Lulëzimit.  
- Po. Urdhëroni.  
- **A mund** të bisedoj me Lulëzimin?  
- Lulëzimi nuk është në shtëpi. Unë jam Mamaja e tij.  
- I thoni **ju lutem**, se e pres në shtëpi.  
- Do t'i them sapo të vijë.  
- **Faleminderit**.



### Si të ftojme

1. Drejtoria e Shtëpisë së fëmijëve; Anila Stefanin;  
Me rastin e Një Qershorit, festës së fëmijëve.  
Në sallën e Shtëpisë së fëmijëve; Në orën 17<sup>30</sup>; Rruga Tuzi, nr.112
2. 1. Emrin dhe mbiemrin e atij që e dërgon.  
2. Emrin dhe mbiemrin e atij, të cilit i dërgohet.  
4. Datën e organizimit të festës.  
6. Adresën ku do të zhvillohet festa.
3. ditën\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_, ora \_\_\_\_

### Si të urojmë?

2. Mirela.; Mamasë.; Me rastin e 8 Marsit, festës së grave.
3. Që ke fituar konkursin ...
- 4.

Mimoza,  Gëzuar ditëlindjen. Me dashuri,  Saimiri	Merr _____. Rruga “ _____ ” Nr.____, _____
--	---

6. a) **emrin dhe mbiemrin;** rrugën, numrin, qytetin dhe kodin postar të qytetit.  
b) **emrin tënd.**

### Teksti dhe fjalia

1. 1. Edlira zgjohet nga gjumi në orën gjashtë.  
2. Hap dritaren dhe bën gjimnastikë.  
3. Pastaj lahet dhe ha mëngjes.  
4. Në orën shtatë e gjysmë niset për në shkollë.
- 2.

a. Edlira	b. Teatri i kukullave
Edlira është një vajzë e bukur. Ajo është e pastër si dëbora. Edlira i do shumë lulet dhe kujdeset për to.	Teatri i kukullave ishte plot me fëmijë. Sapo dolën kukullat, fëmijët filluan të qeshnin. Shfaqja qe e bukur. Fëmijët dolën të gëzuar nga shfaqja.

a. tri fjali; b. katër fjali

4. a) Ai e ka takuar Luljetën, kur ishte dy vjeç.  
b) Kur e ka takuar ai Luljetën?  
c) Vërtetë ai e ka takuar Luljetën, kur ishte dy vjeç!  
a) Ajo nuk kujton asgjë nga ai takim.  
b) A kujton ndonjë gjë nga ai takim?  
c) Vërtetë ajo nuk kujton asgjë nga ai takim!

5. *Pranvera: Çfarë të tha nëna kur iku?*  
*Edlira: Më tha se do të kemi miq sot. Do të vijë gjyshi dhe gjyshja.*  
*Pranvera: Jo, nuk është e vërtetë. Ata banojnë në Kosovë.*  
*Edlira: Po, po do të vijnë që në mëngjes.*  
*Pranvera: Po mua pse nuk më tha?*  
*Edlira: Nuk të tha që të gëzohesh më shumë kur t'i shohësh.*  
*Pranvera : Rrofsh! Jeni të mrekullueshëm!*
6. + *Ishte ditë e bukur.*  
 - *Nuk kishte re.*  
 + *Dielli shkëlqente gjithandej.*  
 - *Nuk frynte erë*  
 + *Dëgjoheshin vetëm cicërrimat e zogjve.*
7. *Agroni nuk këndon bukur.*  
*Ai nuk di shumë këngë.*  
*Agroni nuk shkoi në shtëpinë e Besës.*  
*Ata nuk kënduan së bashku.*
8. *Agimi shkoi në shtëpinë e Mirës.*  
*Ai e la vetëm motrën e vogël.*  
*Prindërit e tij ishin në shtëpi.*
9. Po, i kam mbushur.                      Jo, nuk i kam mbushur.  
 Po, tani po bie shi.                      Jo, tani nuk po bie shi.  
 Po, më pëlqejnë librat.                Jo, nuk më pëlqejnë librat.  
 Po, kam hipur në avion.                Jo, nuk kam hipur në avion.

### Fjalë që tregojnë njerëz, kafshë dhe sende

2. Fëmijët; Mësuesit; Zogjtë; mjekët  
 3. Skënderbeu; shpatë; jave; Gjergj Kastrioti; farkëtari; Puna; mjeshtër; shpatën; shpata; Gjergj Kastriotin.  
 4. Vendosini emrat në shtyllën përkatëse.

Emra të përveçëm	Emra të përgjithshëm
Ostren	shtëpi
Astrit	murator
Kastrat	fushë
Moraça	lumë
Adriana	rrugë

5. Malit të Zi; Cetinja; Mal të Zi; Limi; Mal të Zi; Podgorica; i Azemit; e Zanës; Kiti.

### Si shkruhen emrat e përveçëm?

4. Ulqini, Tivati, Kotorri, Adriatik;      Bari, Budva, Herceg-Novi  
 Podgorica, Ribnicës, Moraçë;      Plava  
 6. + Në Podgoricë ka ndërtesa të bukura.  
 - Në Malin përballë banesës sonë ka gjithmonë borë.  
 - Mitati, natasha dhe kola janë nga Tuzi.

7. Andi, Vera, Spiroja, Pali, Gëzimi, Jaku, Hëna dha Laura po shkonin në kodrat përreth qytetit. Thirrën edhe Vangjelin e Mimosën që kishin ardhur nga Ostreni në shkollën e tyre.

U nisën herët dhe në orën nëntë arritën në sheshin që ndodhej afër majës së kodrës. Prej andej shihej qyteti i Ulqinit dhe malet përreth. Pasi u çlodhen nga rruga, vendosën të luanin topaluftash. U ndanë në dy grupe me nga pesë lojtarë secili. Vangjeli e Mimoza ishin në një grup me Andin, Spiron dhe Verën. Në grupin tjetër ishin katër të tjerët. Loja qe e fortë. Të parët që dolën nga loja ishin Pali dhe Mimoza. Loja vazhdoi gjatë dhe fituese doli Laura. Ata kaluan së bashku një ditë të bukur.

### Fjalë që tregojnë cilësi

#### 6. Shkruani mbiemra me kuptim të kundërt

- |            |            |
|------------|------------|
| - i gjerë  | - i thatë  |
| - i thellë | - i lehtë  |
| - i rëndë  | - i bardhë |
| - i ftohtë | - i mirë   |
|            | - i gjatë  |

7.

Mbiemra	Mbiemra të nyjshëm	Mbiemra të panyjshëm
i pastër	i pastër	
i zgjuar	i zgjuar	
trim		trim
i rëndë	i rëndë	
i lartë	i lartë	
guximtar		guximtar
i ftohtë	i ftohtë	
djegës		djegës
zemërmirë		zemërmirë

### Fjalë që tregojnë veprime

- sheh; lexon; pastron.
- shikoj, shquaj, dalloj, diktoj, vë re, vërej  
vete, nisem, iki, largohem  
tregoj, dëftej, them  
thërres, këlthas, çirrem, gërthas,
- punoj; këndoj; notoj; ujit; vrapoj; peshoj; postoj.
- erdhi; dha; hapi; buzëqeshi
- shkruan; nis; viziton; bën(mur), vë(tulla); zdrukthon; gatuan.
- mat; qep; pret; hekuros.
- leh; blegërin, mjaullin; pëllet.
- doli; hipi; u shtri; iu afrua; u largua; zbriti. 9. vizaton; shkruan
- qëndis; lexon; poston.
- dha; mori; gjeti.

## Kryefjala dhe kallëzuesi

3.

b) ujit +; a) vajza +

4. Arta (kryefjala); vesh (kallëzuesi); Erleta dhe Anita (kryefjala); luajnë (kallëzuesi).

## Dy pikat dhe presja

1. + Në teatrin e kukullave shkuan: Qaniu, Roberti, Jovani dhe Kristina.

4. Koleci shkoi në librari. Me të shkuan edhe shokët e tij: Astriti, Ornela, Lejlaja dhe Arta.

Ai donte të blinte mjete të ndryshme mësimore: lapsa, fletore, gomë dhe vizore.

Shokët e tij donin të blinin: fletore vizatimi, bojëra dhe lapsa me ngjyra.

Kur po dilnin u kujtuan se kishin harruar të blinin: prefëse, bojë shkrimi dhe maja pene.

U kthyen edhe një herë në dyqan dhe morën gjithçka që iu duhej.

## Toka rrotullohet

1. për një ditë +; për një vit +; rreth Diellit +; Dielli +

2. ujë +

3. ajri +

## Edhe Hëna rrotullohet

1. rreth vetes +; rreth Tokës +; për më shumë se njëzet e shtatë ditë +

2. dielli +

3. toka

## Emrat kanë gjini dhe numër

1.

Emra që mund të marrin -i, -u	Emra që mund të marrin -a, -ja
viti	stina
dimri	pranvera
uji	vera
akulli	vjeshta
ajri	sipërfaqja
	rrezja

2. **Mashkullorë:** lëmshi; topi; rezultati; rrotullimi.

**Femërorë:** Toka; ora; dita; nata.

3.

Emra	Emra të gjinisë mashkullore	Emra të gjinisë femër
<i>pyll</i>	+	
<i>mal</i>	+	
<i>fushë</i>		+
<i>kodër</i>		+
<i>dru</i>	+	
<i>pemë</i>		+
<i>gjethe</i>		+
<i>lule</i>		+

5.

Emrat në numrin njëjës	Emrat në numrin shumës
dita	anijet
shkëmbi	dritat
rruga	muajt
stina	njerëzit
rrezja	
viti	
java	

6. Njëjës: Hëna; lëmsh; Toka; anije; Dielli; Hënës.  
Shumës; ditë; javët.

7.

Emra	Emra në njëjës	Emra në shumës
<i>pyje</i>		+
<i>det</i>	+	
<i>male</i>		+
<i>fushë</i>	+	
<i>kodër</i>	+	
<i>drurë</i>		+
<i>ujë</i>	+	
<i>përrenj</i>		+
<i>lumë</i>	+	

9. a) Muratorët po ndërtojnë disa shtëpi të reja.  
b) Disa fëmijë po shikojnë me vëmendje punëtorët.  
c) Fëmijët dëshirojnë të bëhen muratorë.

## Mbiemrat kanë gjininë dhe numrin e emrave

1.

Mbiemra të gjinisë mashkullore	Mbiemra të gjinisë femërore
mal i lartë	erë e lehtë
lumë i thellë	hënë e plotë
qiell i kaltër	
diell i nxehtë	

2. **Mbiemra mashkullore:** (djalë) *i rregullt*; (pantollona) *të shkurtëra*; *i gëzuar*.

**Mbiemra femërore:** (vajzë) *e rregullt*; (grykësen) *e zezë*; (jakë) *të bardhë*;  
(sandalet) *e zeza*; *e gëzuar*; (këpucë) *të zeza*.

3. **Mbiemra mashkullore:** (bar) *të njomë*; (zërat) *gazmorë*; (fëmijë) *të lumtur*.

**Mbiemra femërore:** (tokat) *e reja*; (pranverë) *e bukur*; (vera) *e nxehtë*.

4.

Mbiemra	Mbiemra mashkullore	Mbiemra femërore
<i>pylli i dendur</i>	+	
<i>mal i lartë</i>	+	
<i>fushë e gjërë</i>		+
<i>kodër e punuar</i>		+
<i>dru i trashë</i>	+	
<i>pemë e lulëzuar</i>		+
<i>gjethe jeshile</i>		+
<i>lule e bukur</i>		+

5. *e re*; *e bukur*; *e lartë*.

7.

Mbiemra në numrin njëjës	Mbiemra në numrin shumës
<i>ditë e bukur</i>	<i>anije të mëdha</i>
<i>shkëmb i thepisur</i>	<i>drita të kuqe</i>
<i>rrugë e gjerë</i>	<i>rreze të ndritshme</i>
<i>stinë e nxehtë</i>	<i>punë të rënda</i>
<i>vit i bukur</i>	<i>burra trima</i>
<i>javë e gëzuar</i>	

8. **Mbiemra në njëjës:** (pjesën) *e bardhë*; (trupin) *e shëndoshë*.

**Mbiemra në shumës:** (dhëmbët) *e poshtëm*; (dhëmbët) *qumështorë*;

(*dhëmbët*) *e pastër*, *të shëndoshë*; (*Dhëmbët*) *e shëndoshë*

9.

Mbiemra	Mbiemra në njëjës	Mbiemra në shumës
<i>pyje të dendura</i>		+
<i>det i kaltër</i>	+	
<i>male të larta</i>		+
<i>fushë e gjërë</i>	+	
<i>kodër e lartë</i>	+	
<i>drurë të gjatë</i>		+
<i>ujë i pijshëm</i>	+	
<i>përrenj të shumtë</i>		+
<i>lumë i cekët</i>	+	

11. a) Disa fshatarë po hapnin toka të reja.  
b) Disa vajza të vogla po i shikonin me vëmendje fshatarët.  
c) Vajzat dëshironin të bëheshin të zonja si fshatarët.

#### Dhëmbët tanë

1. *dy herë* +; *njëzet* +; *njëzet e tetë* +
2. 32
3. kurora; rrënja

#### Fjalë që zëvendësojnë emrat

1. unë, ne; ju; ai; ti, ata (ato).
2. ajo; ai; ato; ata.
3. Ajo; Ai; Ato; Ata

#### Tek ne rriten shumë zarzavate

1. *e freskët* +; *sallatë* +; *gjellë* +.

#### Dje, sot, nesër

1. gjashtë; tetë.
2. e martë; e enjte.
3. pas; para; pas; para; pas; para.

dje                      *Nëna i bleu Erandës një kukull flokëverdhe.*  
mbrëmë                *Eranda i qepi kukullës një fustan të ri.*  
nesër                    *Eranda do ta nxjerrë për shëtitje kukullën saj.*  
tani                      *Eranda dhe kukulla po bëhen gati për të fjetur.*

5. *e shkuar*; *e tashme*; *e ardhme*.

## Foljet ndryshojnë

1. Unë; Ai (ajo); Ne; Ata (ato); Ti; Ju;

2.

Përemrat vetorë	Foljet
unë	dëgjoj
ti,	dëgjon
ai (ajo)	dëgjon
ne	dëgjojmë
ju	dëgjoni
ata (ato)	dëgjojnë

3.

Përemri vetorë	kam	jam
unë	kam	jam
ti	ke	je
ai, ajo	ka	është
ne	kemi	jemi
ju	keni	jeni
ata, ato	kanë	janë

4. *Unë punoj; Ti punon; Ai (ajo) punon; Ne punojmë; Ju punoni; Ato (ato) punojnë;*

### Tek ne ka shumë fruta

1. *domate, bishtajë, bamje, patëllxhanë, (zarzavate) pjeshkë, dardhë, kumbulla, kajsi (fruta)*
2. molla; portokalli.
3. fiku; molla; rrushi.

### Pjesët plotësuese të fjalisë

3. Blerta rregullon lulet në vazon prej qelqi.  
Besa lyen këpucët me bojë.  
Postieri solli një letër për babanë e Artanit.
4. 1. jakën e bardhë të grykëses.; 2. majën e malit përballë nesh.; 3. nga bora.

### Tek ne ka shumë lloj peshqish

1. + ngjalë; + sardele; + qefull; + krap; + troftë.
2. ngjalë; gjuhçë.
3. a) qefull; b) troftë; c) sardele.

### Viti i Ri

3. a) pemën e Vitit të ri; b) Plakun e Vitit të Ri.





CIP - Каталогизација у публикацији  
Централна народна библиотека Црне Горе, Цетиње

37.016:811.18(075.2) (076)

BECI, Bahri

Valle fjalësh dhe fjalish : gjuha shqipe 3 : për klasën e tretë të shkollës fillore nëntëvjeçare : libri i mësuesit / Bahri Beci ; [ilustrimi Simon Vučković]. - 1. izd. - Podgoricë : Enti i teksteve dhe i mjeteve mësimore, 2007 (Podgorica : Studio Mouse). - 74 str. ; ilustr. ; 30 cm

Tiraž 50.

ISBN 978-86-303-1218-2

a) Албански језик - Приручници  
COBISS.CG-ID 12076560